

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7754 E shtunë 5 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**T**ë gjithë biem dakord së Pakti për Universitetin nuk mund të zgjidhë asnjë nga kërkesat tona. Pakti është thjesht një manovër e qeverisë për të na shitur ...

Vijon në faqen 20

Nga AGRED TAJAJ

Arsyetim mbi përjasjen tonë



Opinion

Ditës

**P**ërzgjedhja nga kryeministri si zëvendës të vet i një deputeti jetëgjatë në Kuvend, me disiplinën më të ulët partiake, asnjëherë i përmendur nga ...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Shuplaka brenda vetes



29-vjeçarja u mbrojt me duart lart

## Vrasja e vajzës në Greqi, ekspertiza: Babai e goditi 7 herë me shufër hekuri

Angelina Petro ishte larguar nga shtëpia për të bashkëjetuar me afganin, i ati nuk e duroi

GREQI-Vrasja makabre e 29-vjeçares shqiptare Angelina Petro nga i ati ka tronditur Greqinë. Ngjarja e rëndë e ndodhur mbrëmjen e 2 janarit në Korfuz ka zënë faqet e para në mediat e vendit fqinj. Kjo ngjarje është trajtuar gjerësisht në emisionin "Mazi sou" (Me ty) të gazetares së njohur greke, Tatiana Stefanidhu në "Skaï TV". ...

Në faqen 9

TE RINJTE REFUZOJNE "PAKETEN" E QEVERISE: DUAM ARSIM PUBLIK FALAS

## STUDENTET NUK TERHIQEN: PROTESTOJME ME 7 JANAR

Rama ofroi zgjidhjen e krizës, studentët nuk e pranojnë. Kryemadhi: Gjinnazistët duhet t'i bashkohen protestës, problem është i gjithë sistemi arsimor



(Në foto) Kristjan Zoto. Studentë duke protestuar



Në faqen 6

ZGJEDHJET

**KQZ-ja, partive: Respektoni afatet, ndryshe nuk do ju regjistrojmë**

Në faqen 2

KAVAJE

**Abuzim me detyrën, KLSH kallëzon në prokurori 7 ish-punonjës Hipoteke**

Në faqen 7

INTERVISTA

**Rrëfihet Edi Muka: Paqëndrueshmëria e skenës së artit, pse u mbyll 'Onufri'**

Në faqen 10-11

RRUGET E BLOKUARA

**Bora "pushton" Shqipërinë, ja si bëhet qarkullimi në Tiranë-Durrës**

Në faqen 12

FINANCAT



**Arben Ahmetaj bën bilancin e 2018: Kemi ulur borxhin. PD: Gënjeshtër**

Në faqen 5



Si qëndron e vërteta e skenës, rrëfihet modelja: Marrëdhënia me veten

## Vildane Zeneli, a u puth në buzë me Tunën?

Në brendësi: Rikthimi i Marinës. Fjolla Morina "tërbon" fansat

NGA PAMELA ALIAJ

**S**i fillim ju uroj një vit të mbarë për 2019! Si e kaluat natën e ndërrimit të viteve? Faleminderit! Edhe unë ju uroj një vit të mbarë e me shumë dashuri, e me të gjitha gjërat që dëshironi në jetë! Këtë vit vendosa të festoja vitin



e ri me familjen time në New York. Ka vite që gjithmonë e ka pritur me ndonjë ishull të bukur por këtë herë doja të isha me familjen dhe ata ishin shumë të lumtur që unë isha me ta të festoja. Duhet të them se ishte viti i ri më i mirë deri më tani! Më kujtoi ...

Suplement

## ZGJEDHJET AKUZAT

Nuk do të mirëkuptohet dhe as tolerohen vonesat në propozimet e komisionerëve

# KQZ apel partive: Respektoni afatet, ndryshe s'do regjistroheni

*Regjistrimi i koalicioneve mbaron më datë 1 maj*

Në kushtet kur partitë politike nuk kanë gjetur ende mirëkuptimin mes tyre për të miratur ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nisur punën për përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme lokale me ligjin ekzistues. Ndaj në respektim të afateve që ka ky ligj zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka bërë thirrje dje partive politike që të respektojnë detyrimet e tyre për ngritjen e komisioneve që do administrojnë zgjedhjet si dhe për dorëzimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiak. Në një dalje për mediat publike, zëdhënësja e KQZ-së, Drilona Hoxhaj ka tërhequr vëmendjen e partive politike të interesuara për zgjedhjet për një sërë procesesh zgjedhore. Më konkretisht zëdhënësja e KQZ-së bëri të ditur se Kodi Zgjedhor ngarkon partitë me detyrën e administrimit të procesit dhe administrimit i procesit zgjedhor fillon me ngritjen e KZAZ-ve. Dhe nisur nga afatet që përcakton ligji deri më datë 18 mars, këto parti duhet të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve). Në rast se partitë nuk e respektojnë këtë afat, kjo e drejtë zbrat tek partitë e tjera parlamentare të të njëjtit grupim dhe, në instancë të fundit, tek KQZ-ja, e cila do të emërojë kryesisht komisionerët deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje. Sipas saj administrata zgjedhore duhet të trajtojë dhe kualifikohet për kryerjen e detyrave, ndaj sipas KQZ-së vonesat në propozime cenojnë përgatitjen profesionale të komisionerëve, rrezikojnë mbarevajtjen e procesit, dëmtojnë cilësinë e zgjedhjeve. "KQZ-ja është e vendosur të mos mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në propozime, prandaj u bën thirrje që sot partitë politike që të organizohen në kohë për përzgjedhjen e kandidatëve për komisionerët zgjedhorë", tha Hoxhaj. Një tjetër detyrim ligjor që duhet të zbatohet nga partitë politike është edhe afati ligjor për regjistrimin e tyre si subjekte zgjedhore. Për këto zgjedhje ky afat mbaron më datë 21 prill, kurse për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ mbaron më datë 1 maj. Regjistrimi bëhet si gjithmonë pranë KQZ-së. Nëse partitë politike nuk respektojnë afatin e parë, ato nuk



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

### FUSHATA

Sipas nenit 77 të Kodit Zgjedhor periudha e fushatës zgjedhore fillon në datën 31 maj. Kryerja e veprimtarive të fushatës përpara fillimit zyrtar të saj prish barazinë e garës në zgjedhje, e bën procesin të disbalancuar dhe të pandershëm, e bën atë që të nisë keq.

## Ndryshimet në qeveri, Greqia: Me Shqipërinë ka një ftohje marrëdhëniesh

Ministri plotësues i Jashtëm grek, Jorgos Katranguklos ka komentuar ndryshimet e bëra së fundmi në kabinetin qeveritar nga kryeministri Edi Rama. I pyetur në një intervistë radiofonike për ndryshimet në qeverinë Rama, është shprehur se zhvillimet e fundit kanë lënë pas marrëveshjen me Shqipërinë, e cila kishte arritur në nivele të kënaqshme gati për zgjidhje. "Por, aty ku prisim të kishim konkludimin e këtij progresi të mirë, në festën e 28 tetorit, që përveç përjetorit festiv kombëtar do të nderonim edhe të rënë në luftën italo-greke në Shqipëri, që për herë të parë gjetën paqe pasi u varrosën me nderime pas 70 vitesh, ndodhi ngjarja e trishtuar



me Katsifën", është shprehur ai. E prej atëherë, "për arsye që kryesisht kanë të bëjnë me politikën e brendshme të vendit fqinj, sipas vlerësimit tim - ka vazhduar Katranguklos, - kemi pasur një ftohje të klimës, por që mendoj se është plotësisht e riparueshme". Përpjekja jonë - ka shtuar diplomati grek, - është pikërisht të risjellim

nivelin e diskutimit, aty ku ishte, dhe të shkojmë drejt zgjidhjes përfundimtare të çështjeve". Katranguklos është shprehur se Athina është për perspektivën europiane të të gjithë vendeve që bëjnë pjesë në Ballkanin Perëndimor, por me parakushtin që të respektohet sistemi i ligjeve dhe rregullat e BE-së. "Kjo për Shqipërinë, jo vetëm që do të thotë ndryshime në shtetin ligjor, por edhe mbrojtje të minoritetit grek. Ndaj fenomenet të tilla, si ai i fundit, që është në thelb konfiskimi i pronës së minoritarëve grekë në zonën e Himarës, janë ndër gjërat që vendi fqinj duhet t'i rishikojë", ka thënë midis të tjerash ministri i Jashtëm plotësues i Greqisë.

do të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019. Nëse nuk respektojnë afatin e dytë, ato nuk mund të konkurrojnë si koalicion zgjedhore. "Në të shkuarën KQZ-ja është kritikuar nga misionet vëzhguese ndërkombëtare për regjistrimin e subjekteve zgjedhore përtej afateve ligjore, ndaj është veçanërisht e vendosur këtë herë që të mos

mirëkuptojë dhe as tolerojë vonesat në aplikimin për regjistrim", - theksoi zëdhënësja e KQZ-së. Një tjetër afat që duhet të respektojnë partitë politike është edhe ai për dorëzimin e listave të kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshilltarë. Sipas Kodit, depozitimi i listave shumë emërore të kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe kandidatëve për kryetar bashkie

duhet të bëhet jo më vonë se data 13 maj. "Nëse partitë politike nuk e respektojnë këtë afat, ato do regjistrohen dhe nuk do figuronin në fletën e votimit. Sot ato janë në kohë për të organizuar punën, sipas procedurave të brendshme statutorë, për të përzgjedhur kandidatët dhe për të plotësuar dokumentacionin e kandidimit", - thuhet në deklaratën e KQZ-së.



Gjatë votimeve për zgjedhjet e fundit parlamentare

### SHKURTE

#### Vasili: Varfëria po djeg Shqipërinë, qeveria 'krihet'

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së Petrit Vasili aku zoi dje qeverinë 'Rama' në lidhje me ekonominë pasi sipas tij shqiptarët provuan vitin e ri më të varfër të tyre. "Varfëria po djeg Shqipërinë dhe qeveria krihet! Shqipëria është në varfëri të hidhur dhe këtë e shohin të gjithë. Qeveria i gënjën prapë ata, ndërkohë që vetëm tre ditë përpara shqiptarët provuan vitin e ri më të varfër të tyre. Tregjet tregojnë qartë se edhe pse çmimet ishin shumë të ulta qytetarët nuk blinin dot", - shprehet ai. Vasili përmend se rënia e konsumeve është e fortë teksa pyet: "Po miliardat e koncesioneve, që FMN insiston të pasqyrohet në Borxhin Publik pse e fshehin? Po mosrealizimet e të ardhurave në kurrit të kujt bien? Po mijëra biznese që mbyllen? Po qindra mijëra shqiptarë pse largohen në emigracion si asnjë popull në Europë? Me këtë propagandë komuniste do vazhdojnë këta, si dikur që hanim me talon dhe qeveria deklaronte se socializmi dhe sukseset e tij marshonin përpara".

#### Rama-Thaçi: Qoftë ky vit i Shqipërisë dhe Kosovës!

Kryeministri Edi Rama ka ndarë në Instagram një foto me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Krahas fotos së publikuar, Rama shkruan se ky vit është i Shqipërisë dhe Kosovës. Rama dhe Thaçi janë të ulur të dy pranë oxhakut të ndezur, ndërsa mbajnë në dorë një gotë me verë. "Qoftë ky vit i Shqipërisë, Kosovës dhe krejt shqiptarisë", shkruan Rama. Kujtojmë se më datë 29 dhjetor të vitit që lamë pas u firmos edhe "Marrëveshja për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës".

#### Kriza, Manjani: 2019 vijon aty ku na la 2018

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani duke renditur problemet e viti të kaluar shprehet se edhe ky vit i ri i sapo nisur vijon me të njëjtat tipare si të 2018. Ai shprehet se janë të njëjtat probleme dhe për fat të keq sa vijon e thellohen për shqiptarët. Sipas Manjanit, kryeproblemi është se shqiptarëve çdo ditë e më tepër po iu ngelen më pak para në xhep dhe jeta e tyre po vështirësohet. "Taksat dhe tarifat e rritura nga njëra anë dhe mungesa e vendeve të punës nga ana tjetër janë ngjarje të përditshme që shtojnë mungesën e parave në xhep dhe shtojnë depresionin. Emigracioni mbetet e vetmja shpresë virtuale e shqiptarëve që vijnë të duan të ikin. Qeveria nuk ofron kryesoren: shpresën se diçka do bëhet më mirë. Vetëm propagandë me shashka, kap-solla e telajo të rëna bastesh. Por nuk llogarit të pak-tën 50 000 njerëz që punonin në to, që tani do t'i shtohen listës së të përhumburve depresivë që nuk dinë se ç'të bëjnë", shprehet z.Manjani.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafide VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Liaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415 e-mail:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotransportit, Tiranë - Tel: (04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel: (04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYTPUR në "Klasik" Shpk



**THIRRJA**

Ministria e Brendshme u bën thirrje qytetarëve që të verifikojnë dokumentet e identifikimit, pasi janë afro 1.4 milionë karta identiteti dhe pasaporta biometrike, që skadojnë deri në qershor 2019, muaj kur mbahen zgjedhjet vendore.

## Bregu, në Sarajevë për detyrën e re: Nuk do të jetë e lehtë

Majlinda Bregu nis zyrtarisht punën si sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. "Nuk do të jetë e lehtë. Do të jetë një sfidë si të notosh mes situatash të vështira ekonomike, shoqërore dhe politike. Jam e bindur që ritmi i zhvillimit rajonal do të ndikojë në ritmin e integritetit tonë evropian, për mua është një privilegj shumë i madh që do të drejtoj KBR ( RC), po aq sa është një sfidë të cilën bashkë me përkushtimin e stafit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal shpresoj ta përballoj fagebardhë!", shkruan Bregu në "Facebook". Ajo nënvizon se në krye të këtij këshilli në zyrat e Sarajevës do të vijojë të jetë i suksesshëm. "Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal ka qenë i suksesshëm në gjenerimin e një mbështetjeje të konsiderueshme për reformat në Europën Juglindore dhe kështu do vijojë të jetë! Për këtë arsye jam e bindur se së bashku, nën drejtimin politik të SEECP dhe mbështetjen e BE, duke përfshirë median, shoqërinë civile, ne do të përpigemi të bëjmë zgjedhje të mençura, që nxisin dialogun me të gjitha grupet në shoqëri", shprehet zg.Bregu.

## Banorët e "Astirit": Do t'i mbrojmë të drejtat tona me gjak

Banorët e zonës së "Astirit" dolën sërisht dje në protestë duke kërkuar anulimin e projektit të Unazës së Re, i cili përgjatë segmentit të tij prek shumë shtëpi në zonën e "Astirit". Banorët deklaruan se tashmë është vërtetuar se ky projekt është abuziv dhe duhet menjëherë të anulohet sa nuk është vonë. Gjithashtu, ata shprehën vendosmëri se shtëpitë e ndërtuara me djersë do t'i mbrojnë me forcë dhe për këtë do të japin edhe jetën e tyre. "Zbatoni ligjin se do të shkoni në burg. Nuk mbulon dot krimin. I bëj thirrje kryetarit të bashkisë të sjellë ndriçimin dhe pemët, të cilat i hoqi këtu. Më shoqëruan pa asnjë shkak. Për çfarë i kapin nënat tona dhe iu bëjnë presione që fëmijët e tyre të mos dalin në protestë, ne do të dalim këtu dhe do të mbrojmë gjakun tonë. Ne kemi 62 ditë që jemi këtu", tha një banor. Deputeti demokrat, Klevis Balliu ishte prezent në protestë, duke mbështetur banorët. Klevis Balliu apeloj për të gjithë qytetarët të mblidhen para Kryeministrit për të rrëzuar Ramën. Një thirrje e bëri edhe për policinë.

Salianji: Qeveria po u shpërndan kuponë organizatave të PS për të blerë votuesit

# Skadojnë kartat e identitetit, PD: Rama po tenton të vjedhë zgjedhjet

"1.4 milionë mundësi që kryeministri t'i blejë"

Valentina Madani

Demokratët akuzuan dje qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama se po tenton sërish të manipulojë zgjedhjet e ardhshme lokale, duke përdorur skenarin me kartat e identitetit. Deputeti demokrat Ervin Salianji shkruan në "Facebook" se 1.4 milionë kartave të identitetit iu skadon afati deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve lokale, duke i parë këto si 1.4 mln mundësi që Rama t'i blejë, duke iu paguar kuponin apo duke iu bërë presion. Madje, Salianji shprehet se qeveria ka nisur që dje shpërndarjen e kuponëve organizatave të PS për të blerë votuesit. "1.4 milionë kartave të identitetit iu skadon afati deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve lokale. 1.4 milionë mundësi që Rama t'i blejë duke iu paguar kuponin, duke i bërë presion apo duke mospajisur me kartë votuesit opozitarë. Qeveria po u shpërndan që sot kuponë organizatave të PS për të blerë votuesit nëpërmjet kuponëve falas. Për këtë arsye, Ministria e Brendshme nuk bën asnjë njoftim, asnjë përpjekje paraprake për ta parandaluar dhe zgjidhur çështjen!", shkruan Salianji.

**PROCESI**

Përgjatë muajve janar-qershor të vitit 2019 skadon afati i kartës së identitetit për 1.4 milionë shqiptarë. Në disa dalje publike, opozita thotë se ky është shqetësim real dhe ndikon në zgjedhjet parlamentare të qershorit. Por, duket se qytetarët nuk kanë qenë të informuar se letërnjoftimet e tyre po skadojnë. Të ndodhur përballë kësaj situatë, strukturat shtetërore kanë nisur një fushatë sensibilizimi. Megjithatë, Ministria e Brendshme dhe pushteti lokal kanë marrë edhe masa të tjera, për të mos u gjendur përballë një fluksi të madh aplikuesish me afrimin e qershorit. Posta Shqiptare, si pjesë e këtij bashkëpunimi mes institucioneve, u bën apel qytetarëve të nxitojnë. Nëse për kartat e identitetit mjafton vetëm kuponin në postë dhe paraqitja pranë kompanisë Aleat, e kundërta qëndron për pasaportat. Aplikuesit duhet të para-



Deputeti i PD-së Ervin Salianji

1.4

**MILIONE**

"1.4 milionë kartave të identitetit iu skadon afati deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve lokale. 1.4 milionë mundësi që Rama t'i blejë duke iu paguar kuponin, duke i bërë presion apo duke mos pajisur me kartë votuesit opozitarë!", deklaroi deputeti Ervin Salianji.

## SHBA-të 5 muaj pa ambasador në Shqipëri, kongresi i kthen Trampit emrin e Kavalec

Kongresi amerikan bllokoi kandidaturën e Kathleen Ann Kavalec për pozicionin e ambasadores së SHBA-ve në Shqipëri. Nominimi i Kathleen Ann Kavalec për pozicionin e ambasadores amerikane në Shqipëri është rikthyer Trampit. Tashmë presidenti amerikan mund të zgjedhë të rinominojë Kavalec, ose të ndryshojë emrin e përzgjedhur për Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë. Nominimi i Kavalec për pozicionin e ambasadores amerikane në Shqipëri mbërriti në Senat në 9 korrik, 2018. Kandidatura e saj mbeti në shqyrtim nga Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë dhe nuk kaloi në votim. Kathleen Ann Kavalec njihet si një diplomate karriere, me një përvojë rreth 30-vjeçare si përfaqësuese e Shteteve të Bashkuara në arenën ndërkombëtare. Kathleen Ann Kavalec aktualisht shërben si Zëvendësdihmës Sekretare në Paris, Zëvendëskoordinatore për Ndi-



Kathleen Ann Kavalec

**DIPLOMATJA**

Kathleen Ann Kavalec njihet si një diplomate karriere, me një përvojë rreth 30-vjeçare si përfaqësuese e Shteteve të Bashkuara në arenën ndërkombëtare. Kathleen Ann Kavalec aktualisht shërben si Zëvendësdihmës Sekretare në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike në Departamentin Amerikan të Shtetit.

mës Sekretare në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike në Departamentin Amerikan të Shtetit. Më parë ka shërbyer si drejtoreshë e Zyrës së Punëve Ruse, Zëvendëshefe Misionit të SHBA-ve në UNESCO në Paris, Zëvendëskoordinatore për Ndi-

hmë në Byronë Evropiane dhe drejtore për Parandalimin e Konfliktëve në Zyrën e Koordinatorit për Rindërtim dhe Stabilizim. Kavalec flet rrjedhshëm gjuhët frënge, rumune, ukrainase, ruse, spanjolle dhe portugeze.

qiten pranë komisarit që i ka nën juridiksion. Për një pasaportë me procedurë të përsheptuar çmimi është 18 mijë lekë. Shqiptarët që jetojnë në Greqi dhe Itali duhet të paguajnë nga 130 euro për t'u pajisur me pasapor-

ta biometrike. Po aq duhet të paguajnë ata që jetojnë në Itali. Ndërsa ata që jetojnë në Belgjikë e Zvicër duhet të paguajnë nga 170 euro. 144 paund duhet të paguajnë shqiptarët që jetojnë në Britaninë e Madhe dhe 240 dol-

larë ata që jetojnë në Shtetet e Bashkuara. Deri në datën e zgjedhjeve, shqiptarët kanë afro 6 muaj kohë për t'u pajisur me letërnjoftimet e reja, pasi në të kundërt nuk do të mund të votojnë.

## ZGJEDHJET VENDORE STRATEGJIA

Në 28 qershor PS do të organizojë sjelljen e shqiptarëve që jetojnë jashtë për të votuar

# Emigrantët, PS: Do i sjellim me autobus për të votuar

Propozimet për garantimin e votës së emigrantëve

Partia Socialiste ka paraqitur në mënyrë të njëanshme në Kuvendin e Shqipërisë një draft të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, ku ndërmjet të cilave parashikon që në zgjedhjet e ardhshme të mundësohet votimi i emigrantëve, atje ku punojnë dhe jetojnë. Për këtë, socialistët kanë parashikuar edhe një sërë dispozitash konkrete, nëpërmjet të cilave parashikojnë se si do të kryhet një votim i tillë. Natyrisht që ky është një zhvillim pozitiv, por që duket jo serioz në kushtet kur kanë mbetur edhe pak muaj nga zgjedhjet lokale dhe ku mungon tërësisht infrastruktura e nevojshme për ta realizuar këtë risi. Por jo vetëm kaq, ajo që e bën edhe më të pabesueshme këtë nismë të socialistëve është pikërisht loja e tyre me votat e emigrantëve. Kështu, ndër në projektligjin e paraqitur për ndryshimet në Kod parashikojnë mundësimin e votës së emigrantëve atje ku ata jetojnë, paralelisht me të ata në diskutimet dhe organizimet partiake kanë marrë masa që edhe në zgjedhjet e ardhshme vendore të 30 qershorit 2019, të mundësojnë sërish sjelljen fizike të emigrantëve në bashkitë prej nga janë në mënyrë që të votojnë kandidatët socialistë. Kështu, në mbledhjen e fundit të Asamblesë Kombëtare Partia Socialiste votoi edhe axhendën politiko-organizative për periudhën janar-qershor 2019 dhe ku ndërmjet të tjerave, flet edhe për çështjen e votimit të emigrantëve. Në asnjë rresht të kësaj axhende nuk parashikohet votimi i emigrantëve atje ku jetojnë, por sërish përcaktohen masat që duhet të merren për t'i sjellë ata fizikisht në Shqipëri dhe për ushtruar të drejtën e votës. "Muaji qershor do të jetë shumë i rëndësishëm me takime të përditshme organizative për të finalizuar qëllimin e votimit të emigrantëve sipas bashkive. Nga data 28 qershor do të organizohet ardhja e emigrantëve mbështetës të Partisë Socialiste në mënyrë të koordinuar sipas bashkive dhe akteve të transportit", - thuhet në axhendën politiko-organizative të PS-së.



Ndonëse që nga zgjedhjet parlamentare të 2013-ës kanë humbur shumë nga aleatët e tyre, socialistët janë të bindur se edhe për zgjedhjet e ardhshme vendore do të organizojnë një koalicion zgjedhor të tyre. Në axhendën politiko-organizative të PS-së flitet edhe për çështjen e koalicionëve. Megjithatë nuk flitet se cila do të jenë partitë e synuara për të qenë pjesë e këtij koalicioni. PS parashikon që të mbajë një takim publik gjatë muajit janar me të gjitha forcat e koalicionit të ASHE-së (Aleanca për Shqipërinë Europiane) i krijuar pikërisht gjatë zgjedhjeve vendore të 2015-s. Nuk dihet nëse me këtë përcaktim që bëhet në këtë dokument të miratuar nga Asambleja Kombëtare parashikohet

Pra, siç shihet edhe nga ky dokument zyrtar i strukturave socialistë, PS edhe për zgjedhjet e ardhshme vendore do të praktikojë të njëjtën skemë për të organizuar ardhjen e emigrantëve nga Italia dhe Greqia, vënien në dispozicion të tyre auto-

## Socialistët rikthejnë ASHE, koalicioni zgjedhor më 15 mars



që në këtë takim publik të thirrur edhe LSI, si pjesë e koalicionit të ASHE-së, megjithatë të dyja palët e kanë bërë të qartë deri më tani se do jenë përballë njëra-

busë falas me kusht që ata të votojnë kandidatët socialistë. Krahas këtyre masave, PS ka vendosur edhe një riorganizim total të strukturave të partisë në emigracion, duke e vënë theksin në zona të caktuara të Italisë dhe Greqisë, ku edhe përqendri-

### AXHENDA

"Muaji qershor do të jetë shumë i rëndësishëm me takime të përditshme organizative për të finalizuar qëllimin e votimit të emigrantëve sipas bashkive. Nga data 28 qershor do të organizohet ardhja e emigrantëve mbështetës të Partisë Socialiste në mënyrë të koordinuar sipas bashkive dhe akteve të transportit".

### STRUKTURAT

Pjesë e masterplanit operacional për fushatën e ardhshme zgjedhor është edhe puna për konsolidimin e strukturave të PS-së. Për këtë qëllim, socialistët do bëjnë riformatimin e organizatave socialiste dhe plotësimi i strukturës së strukturës së sekretariatit të Koordinimit Elektoral.



Asambleja Kombëtare e PS-së

### Zgjedhjet vendore, PS do kryejë censusin e votuesve në çdo bashki

Krahas ndryshimeve në Keveri, Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste vendosi që deri në 5 mars të këtij viti, të gjitha organizatat socialiste të riformatohen ku për çdo Qendër Votimi të ketë 1 organizatë. Vetë organizata nuk duhet të ketë më pak se 10 anëtarë, ku të paktën 3 prej tyre të jenë nën moshën 30 vjeç dhe me arsim të lartë. Objektivi i socialistëve është që në çdo zonë ku ka një organizatë, të ketë një anëtar partie për 26 banorë. I gjithë ky proces riformatimi do të jetë detyrë kryesore e drejtuesve politikë të qarqeve që janë ministrat e shkarkuar, por disa prej tyre edhe ministrat të mbetur në detyrë. Po ashtu, Partia Socialiste do të ngrejë strukturat e koordinimit elektoral për çdo qark, bashki, njësi administrative dhe Qendër Votimi, të cilët do të kryejnë sipas detyrës evidentimin e votuesve të Partisë Socialiste, dhe të partive të tjera të përcaktojnë numrin e votuesve për herë të parë si dhe të evidentojnë zgjedhësit potencialë të majtë dhe të djathtë si dhe zgjedhësit e lekundur; të pavendosur dhe që nuk votojnë.

### “PATRONAZHI

Edhe në zgjedhjet e ardhshme vendore, PS do të ngrejë sistemin e saj të patronazhit. Organizimi do bëhet i ndarë në dy kategori, sistem patronazhi për votuesit tradicional dhe sistem patronazhi për jotrondicional.

tjetrës në këtë betejë elektorale. Në këtë takim publik do të diskutohet me aleatët për Kodin Zgjedhor, programin qeverisës, si dhe organizimin e përbashkët. Në shkurt PS

mi shqiptarëve është më i madh. Në kuadër të këtij organizimi, socialistët kanë parashikuar që në 15 janar të mbajnë mbledhjen e Asamblesë së PS-së për Greqinë e Athinë. Ndërkohë që nga 15 janari deri në 15 shkurt do të bëhet një organizim më

ka programuar që të mbajë një takim dytë me të gjitha forcat e ASHE-së, i cili do të shërbejë si një takim praktik për nënshkrimin me pas të marrëveshjes dhe rregullores së bashkëpunimit. Më 15 mars socialistët kanë programuar që të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me të gjitha forcat që do të pranojnë të jenë pjesë e këtij koalicioni. Krahas këtyre takimeve, do të zhvillohen edhe takime konsultative në çdo qark me faktorët e koalicionit dhe faktorët të partive të vogla për përcaktimin e këshilltarëve në listat e kandidatëve për këshillat bashkiakë.

specifik i punës së koordinatoreve të emigracionit në Greqi, me synim evidentimin e problematikave apo çështjeve në lidhje me procesin e votimit të emigrantëve. Ndërkohë që në 15 mars do të ngrihet grupi koordinativ për emigrantët në Itali.

**Njoftim për shitje me ankand të tretë**  
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 568,577 e vijues të K.P.L.C do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e pales debitorë B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shifet në ankand përbëhet nga:  
"Tullu" + "Godine", me numër pasurie 14/283 ndodhur në Lagjen 10 Korriku dhe e regjistruar pranë ZVRPP-Vlorë, e ndodhur në Z.K.Nr.8602, volum 35, faqe 144, me sipërfaqe tullu 300 m2, sipërfaqe e kati përde 117.3 m2. Ankandi i tretë fillon me çmimin fillestar në masën 5.644.800 Lekë.  
Ankandi qendron i hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datë 23.01.2019 në orën 15:00 në Bulevard "Gj. Frashë" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Ofertuesit duhet të kthejnë dokumentacionin si dhe të kontaktojnë tel. 67 20 82 543 e-mail: jllr\_dervishaj@yahoo.com ose WEB [www.powerjustice-al.com](http://www.powerjustice-al.com).

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 21.01.2019 ora 8:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Ate me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman. Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi, me vlerë fillestare në ankand 420,004 (Katerqind e njezet mijë) LEKE.  
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email [enuar.merko@gmail.com](mailto:enuar.merko@gmail.com).

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**  
**ZYRA PERMBARTIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**  
A. PASURIA nr. 281 / 10, e lojit "Arë", zona kadastrale 2631, volum 18, faqe 15, sipërfaqe 1.000 m2, adresë: Mborje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 2.168.144 Lekë.  
B. PASURIA nr. 187 / 20, e lojit "Arë", zona kadastrale 2631, volum 11, faqe 250, sipërfaqe 1.500 m2, adresë: Mborje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 739.140 Lekë.  
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.01.2019. CEL. 0684026666 / 0693262866.



Bilanci për ekonominë, Tabaku: Paturpësi, u tjetërsuan shifrat e financave

# Ahmetaj bën bilancin e 2018-ës: Ulëm borxhin. PD: Gënjeshtër

"Viti 2013, 'lugina e errët' e ekonomisë"

Valentina Madani

Në mbyllje të detyrës si ministër i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj u shfaq dje përpara mediave me bilancin e dikasterit të drejtuar prej tij përgjatë vitit që lamë pas, duke e cilësuar 2018-ën të suksesshëm në përm-bushjen e reformave. "Kemi rritjen më të lartë ekonomike në rajon, 4.5%, shifrat flasin vetë. Papunësia sot është në nivelin më të ulët historik, 12.2%, borxhi 63.6%. Qeveria 'Rama' nuk krijoi borxh të ri. Këtë e kam krenari politike, personale, profesionale. Ulja e borxhit do të vazhdojë", deklaroi z.Ahmetaj. Gjatë bashkëbisedimit me gazetarët, ministri i Financave në detyrë përmendi se viti 2013, kohë kur e majta erdhi në pushtet, ishte "lugina e errët" e ekonomisë. Mes të tjerash, ai deklaroi se tashmë vendi ynë ka rritjen më të lartë ekonomike në rajon.

"Rritja ekonomike, shifrat nuk i sfidonin dot. Papunësia në nivelin më të ulët historik, 12.2%". Kemi shumë për të bërë, ka shumë punë për të luftuar varfërinë, por e kemi lënë pas vitin 2013. Konsumi qytetar ka ardhur duke u rritur", tha Ahmetaj. Sipas tij, qeveria "Rama 2" nuk krijoi borxh të ri. "Qeveria 'Rama 2' nuk krijoi borxh të ri, por lehtësoi qytetarët nga borxhi. Unë jam krenar edhe për këtë shifër, që është reformë", pohoi ai. Ahmetaj tha ndër të tjera se viti 2018 do shënojë rekord, pasi ka 1 miliard investime të huaja. Sipas Ahmetajt, ekonomia vendëse ka 5 vite që vetëm rritet. "Viti 2018 do shënojë rekord. Kemi 1 miliard euro investime të huaja. Qytetarëve u vjen për të vjedhë kur dëgjojnë se është bërë diskurs. Janë 38 mijë biznese neto. Ekonomia ka 5 vite vetëm rritje. Kryeministri ka të drejtë kur thotë se është e pamjaftueshme, por imagjinoni sikur nuk do kishte 38 mijë biznese të reja, por do kishim 28 mijë biznese më pak. Kredia me probleme është në nivelet më të ulëta që prej vitit 2014. Eksportet rriten konsiderueshëm në 11-mujor me 15%. Është rritur ekonomia dhe sipërmarrja vendëse. Janë rritur shërbimet dhe kjo është arsyeja pse është forcur leku. Në makineri dhe pa-



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj



Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku

## REAGIMI

Për demokratën Jorida Tabaku, bilanci i bërë dje nga ministri i Financave, Arben Ahmetaj për 2018-ën prodhon gënjeshtër të denja për Rilindjen. Tabaku e akuzoi

## ARBEN AHMETAJ

Ministri Ahmetaj paralajmëroi se deri në fund të 2019-ës qeveria do të ezaurojë të gjitha detyrimet e prapambetura, duke shënuar njëherazi edhe një shifër rekord të investimeve të huaja në vlerën e 1 miliard eurove.

qeverinë dhe Ahmetajn për tjetërsim të shifrave të financave publike. Sipas saj, familjet shqiptare po varfërohen dita-ditës, bizneset po falimentojnë, ndërsa investitorët e huaj kanë zgjedhur të braktisin vendin. "Sipas raportit të KLSH, ministri Ahmetaj rezultoi të ketë falsifikuar borxhin publik duke gënjyer parlamentin dhe mbi të gjitha, duke gënjyer shqiptarët. Rritja e borxhit vjen si pasojë e PPP-ve që në vitin 2018 kanë qenë kryefjala e vjedhjeve spektakolare të kulmuara me ligje apostafat për të ligjëruar këto vjedhje. Ligji i Teatrit, ligji për koncesionin e aeroportit të Vlorës, ligji i inceneratorëve, të gjitha këto janë disa prej 'mekullive' që ka kontribuar vetë ministri Ahmetaj me gjithë kapacitetet e tij dhe fuqinë e ministrit", tha Tabaku. Deputetja e PD-së vë në dukje se detyrimet e prapambetura kapin vlerën e 200 milionë eurove, ndërsa bizneset vazhdojnë të mbyllen dhe të vendosen në vështirësi. Më tej, ajo shprehet se vlera e taksave të rritura nga paketa fiskale 2014 e deri më sot është e barabartë me 1.9 mld euro, ndërsa vlera e PPP-ve është 2 mld euro. "Shqiptarët paguan më taksat e tyre paratë që qeveria çon tek oligarkët, që jo rrallëherë kanë përgatitur ligjet specifike dhe paketën fiskale. Ministri ndërsa propagandonte taksën progresive, harroi të nënvizonte taksën mbi të ardhurat, që është më e larta në rajon. Harroi të propagandonte futjen e TVSH-së për bizneset e vogla, raportet e ndryshme në kombëtarë që evidentojnë problemet e politikës fiskale të qeverisë rilindase. Vetëm për vitin e kaluar buxheti të shtetit i mungojnë 126 milionë euro si rezultat i keqmenaxhimit dhe korrupsionit", tha z.Tabaku.

## JORIDA TABAKU

"Sot borxhi publik, sipas raportit të KLSH-së, rezultoi të jetë 73% e PBB-së dhe kjo vlerë është më e lartë se sa deklarimi i qeverisë në komisionet parlamentare. Sipas raportit të KLSH-së, ministri Ahmetaj rezultoi të ketë falsifikuar borxhin publik duke gënjyer parlamentin dhe mbi të gjitha duke gënjyer shqiptarët", tha zj. Tabaku.



## Rama: Ulja 3 herë e tatim-fitimit, nxitje për biznesin dhe punësimin

1 janari shënoi hyrjen në fuqi të paketës së re fiskale, nga e cila bizneset me xhiro vjetore nga 8 në 14 milionë lekë të reja do të përfitojnë ulje të tatim-fitimit, nga 15% në vetëm 5%. Kryeministri Edi Rama vizitoi dje një prej sipërmarrësve që përfiton nga kjo ulje e taksave. "Tani, singlerisht ne po ndihemi mirë, se na u ul taksat e tatim-fitimit. Unë bëja 100 milionë lekë xhiro në vit dhe paguaja 15 milionë lekë. Tani ne paguajmë 5 milionë lekë. Unë do investoj më shumë tani. Do marr më shumë punëtorë. Shumë faleminderit, singlerisht!", deklaroi z.Teliti. Për kryeministrin Rama, kjo lehtësi fiskale për biznesin do të përkthehet edhe me më shumë vende të reja pune, si dhe me rritje të pagave të të punësuarve në sektorin privat. "Ajo që është më e rëndësishmja, në këndvështrimin tonë, është që duke ju lehtësuar 3-fish, ju japim mundësi që të zhvilloheni me investime të reja dhe besoj, menjëherë, ju do mendoni për një investim të ri për t'u zgjeruar, për t'u konsoliduar dhe e dyta, për të rritur punësimin dhe për të rritur pagat", u shpreh kryeministri. Z.Rama përsërit synimin për mbështetjen e arsimit profesional. "Kemi nevojë të ulim numrin e atyre që shkojnë në universitet dhe të rrisim numrin e atyre që shkojnë në arsim profesional dhe në kolegje profesionale 2-vjeçare, që të bëhen specialistë", deklaroi z.Rama. I pranishëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj shpjegoi se nga paketa e re fiskale përfitojnë një sërë kategori sipërmarrësish, por edhe mijëra qytetarë, të cilëve nga 1 janari iu ulen tatimi mbi të ardhurat personale.

## Unaza e Re, PD: Kompania "DH Albania", 15 mln euro tendera

Demokratët akuzuan dje qeverinë se përgjatë 2018-ës përmes taksave të larta dhe klimës jo të favorshme në vend u mbyllën me mijëra biznese. Sipas këshilltarit për ekonominë, Dorian Teliti, viti që lamë pas ishte një nga më negativët e qeverisjes "Rama", për sa i përket ekonomisë. PD nënvizon numrat e bizneseve të falimentuara. "15.340 biznese kanë falimentuar nga janari deri në dhjetor. Kush thotë se këto janë kompani bixhozi, gënjën! Të tilla, të regjistruara në Qendrën e Bizneseve numërohen me gishtat e një dore. Do të thotë 62% biznese të mbyllura më shumë se një vit më parë. Janë mbi 15 mijë familje shqiptare që nuk u kanë mbijetuar gjobave të taksidave, që nuk i kanë mbijetuar skemës dërrmuese të TVSH-së", tha z.Teliti. Të vetmet biznese që u hapën, sipas opozitës, janë ato të lidhura me qeverinë, duke iu referuar kompanisë "DH Albania", e cila u shpall fituese për ndërtimin e njërit prej lotëve të Unazës së Madhe. "DH Albania", kompania fantazmë që u regjistrua në korrik dhe brenda pak javësh mori 50 milionë euro tendera, është fytyra e ekonomisë që ka ndërtuar Edi Rama: falimentim me taksat dhe gjoba të rënda për shqiptarët e zakonshëm, miliona euro për kompanitë e parajsave fiskale, me të cilat ndan pushtetin", deklaroi zyrtari i PD-së.



## PARALAJMËRIMI

Demokratët paralajmëruan një skenar akoma më të zymtë për bizneset me hyrjen në fuqi nga 1 janari të vendimit të qeverisë për dyfishimin e taksës së pronës dhe zbatimin e koncesionit të kasave të reja fiskale.

Medar KAJOLLI Permbues Gjyqësor Privat me seli në Rr. 'Urani Pano' Pll.1/3, Kati-2, Tiranë, nxjerr në shirit në ankand pasuritë e paluajtshme si me poshte;

\*Pasuria Nr. 1/574, Vll. -32, lqj.-207, Z.K-8210, Illoj Njësi me Sip.-32 m2, Tiranë, me vlerë 3'591'072 (Tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e dy) Lekë, në pronësi të debitorit Z.Besnik Biriku.

Shitja e pasurive të paluajtshme do të bëhet (Zhvillohet) në datë 11.01.2019, ditën e Premte, ora 16.00 në Zyrën e Permbuesit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, në Adresën Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati-2, Tiranë.

Për informacione mund të kontaktoni  
Nr.Tel.-355 66 20 333 63, ose në Adr.-email:medar.kajolli@gmail.com

## Kryetarja e LSI: Problematika në gjithë zinxhirin arsimor

### Kryemadhi: Gjinnazistë, duhet t'i bashkoheni protestës së studentëve, mos u stepni

#### SISTEMI ARSIMOR

"Reformimi i sistemit arsimor nuk bëhet as me dëshirë e as me piktura, por bëhet me punë, bëhet me përkushtim dhe mbi të gjitha bëhet me një angazhim dhe një vullnet politik të qeverisë, gjë e cila nuk vjen si rezultat i një partie politike, por reforma në arsim duhet të vijë si rezultat i një bashkëpunimi kombëtar".



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim Monika Kryemadhi ka marrë pjesë ditën e djeshme në një tryezë bashkëbisedimi, të organizuar nga Lëvizja Rinore për Integrim me gjinnazistët e kryeqytetit dhe strukturat e LRI në gjimnaze, ku në fokus të këtij takimi kanë qenë problematikat në fushën e arsimit. Kryemadhi tha se LSI prej kohësh ka ngritur zërin për "Ligjin e Arsimit të Lartë", ndërsa theksoi se problematikat në arsim nuk janë vetëm në universitete, por në të gjithë zinxhirin arsimor. Ajo u ndal kryesisht të problemet që hasin gjinnazistët që lidhen me orët private, me kërcënimet

politike të drejtoreshave të gjimnazeve etj.

#### REFORMIMI NË ARSIM

Kryemadhi tha se Reformimi i sistemit arsimor nuk bëhet as me dëshirë e as me piktura, por me punë konkrete, përkushtim dhe

vullnet politik. "Reformimi i sistemit arsimor nuk bëhet as me dëshirë e as me piktura, por bëhet me punë, bëhet me përkushtim dhe mbi të gjitha bëhet me një angazhim dhe një vullnet politik të qeverisë, gjë e cila nuk

vjen si rezultat i një partie politike, por reforma në arsim duhet të vijë si rezultat i një bashkëpunimi kombëtar. Pse e themi këtë kombëtar? Sepse partitë politike dhe qeveritë ndryshojnë sipas humorit të kryeminis-

trit, por reforma në arsim, sistemi në arsim nuk mund të ndryshojë sa herë t'i dojë qejfi ministrit apo ministres apo drejtorit të përgjithshëm të arsimit të lartë apo të arsimit të mesëm e kështu me radhë",

tha Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së tha se gjinnazistët nuk duhet të stepen nga presionet e drejtorëve të gjimnazeve, por t'i bashkohen protestave të studentëve për të arritur një nga fitoret me të mëdha të rinisë shqiptare.

"Pothuajse asnjë nga kërkesat tona nuk është plotësuar. Kërkojmë arsim publik falas"

Voltiza Duro

# Protesta, studentët rikthehen para Kryeministrit më 7 janar

*Kristjan Zoto: Të rrëzohet ligji për arsimin e lartë*

Pas miratimit të vendimeve të përfshira në Paktin për Universitetet, studentët e universiteteve publike në vend të të rikthehen sërish në protesta në datën 7 janar. Ata kërkojnë fuqimisht rrëzimin e ligjit të arsimit të lartë, pasi ky i fundit sipas tyre e ka sjellë situatën në këtë pikë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Kristjan Zoto, student në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit e njëkohësisht aktivist i lëvizjes "Për Universitetin" tregon se kërkesat e studentëve pothuajse nuk janë plotësuar pas vendimeve të qeverisë. Ai thekson se barazia e votës nuk është realizuar, bordet e administrimit do vazhdojnë të jenë në kontrollin e qeverisë, buxheti për arsimin nuk tregon se si dhe sa do të rritet, tarifat janë përgjysmuar përkohësisht vetëm për këtë vit dhe vetëm për nivelin bachelor të studimeve. Studentët do të vazhdojnë bojkotimin e mësimin të hënën dhe do të vendosin me tej në sheshin para Kryeministrit se cilat do të jenë format e protestës që do të ndjekin deri në plotësimin e kërkesave të tyre.

**Në fundin e muajit dhjetor, kryeministri Edi Rama ka miratuar disa vendime të përfshira në Paktin për Universitetet. Sa janë plotësuar kërkesat e studentëve bazuar në këto vendime?**

Kërkesat e studentëve nuk janë plotësuar pothuajse fare. Barazia e votës nuk është realizuar, bordet e administrimit do vazhdojnë të jenë në kontrollin e qeverisë, buxheti për arsimin nuk tregon se si dhe sa do të rritet, tarifat janë përgjysmuar përkohësisht vetëm për këtë vit dhe vetëm për nivelin bachelor të studimeve. E për të gjitha këto duhet të anulohet ligji!



Kristjan Zoto, student në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit



#### "BOJKOTIM MËSIMIT"

Vendimet merren në shesh në varësi të dinamikave të ngjarjeve. Por e sigurtë është që në datën 7 janar studentët do të jenë përsëri të shumtë e të bashkuar në shesh duke e vazhduar bojkotin e mësimin deri në plotësimin e kërkesave.

#### KËRKESAT E STUDENTËVE

1. Përgjysmimin e tarifave në TË GJITHA nivelet e studimit (sidomos në master).
2. Rritjen në 50% të peshës së VOTËS STUDENTORE.
3. Dyfishimin e BUXHETIT TË SHTETIT për universitetet publike.
4. Ndalin e financimit publik të UNIVERSITETEVE PRIVATE.

\*Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa RRËZIMIN E LIGJIT TË ARSIMIT TË LARTË.

**Shumë studentë janë shprehur se këto vendime nuk i kanë dhënë zgjidhje situatës së tyre. Sipas jush si mund të plotësohen kërkesat e studentëve?**

Qeveria nuk mund t'i plotësojë kërkesat pa rrëzuar ligjin, i cili e ka sjellë situatën deri në këtë pikë.

Mos harroni maturën shtetërore, rritja graduale e tarifave dhe ndarja e buxhetit me universitetet private, janë disa nga problematikat e këtij ligji. Prandaj si fillim duhet anuluar ligji dhe pastaj të fillohet hartimi i një ligji të ri, demokratik ku duhen bërë konsul-

timet me ata që e jetojnë përditë universitetin, pedagogët dhe studentët. Kjo gjë nuk është bërë me këtë ligj që kemi, pasi ka ardhur nga sirtarët e universiteteve private.

**Asnjë vendim nuk përcaktonte ulje tarifash për programet e ciklit të dytë të studimeve, master, çka shkaktoi dhe revoltë në radhët e studentëve. A duhet të ketë përgjysmim të tarifave në master?**

Në si Lëvizje Për Universitetin jemi për parimin e universitetit publik falas në çdo lloj niveli studimesh, ashtu siç e kanë Hungaria, Polonia, Sllovakia, Çekia, Greqia, Estonia, Sllovenia, Qipro, Gjermania, Skocia, Austria, Suedia, Luksemburgu, Finlanda, Islanda, Norvegjia e Danimarka, ku studentët hyjnë në universitet sipas meritës dhe jo si-

pas thellësisë së xhepit. Përgjysmim i tarifave është vetëm hapi i parë drejt arsimit falas dhe cilësor për të gjithë. Unë kam disa vite që jam aktivist i Lëvizjes Për Universitetin dhe më ka rastisur të takoj shumë studentë dhe deri tani nuk kam rastisur asnjë që nuk e do arsimin publik falas. Të vetmit që janë kundër janë pronarët e diplomave private, të cilët nuk duan të heqin dorë nga fitimet e tyre në kurriz të dijes, duke e kthyer atë në mall si të jetë domate.

**Në vendime theksohej se do të ngriheshin disa grupe pune për transparencën dhe verifikimin e punës së pedagogëve në IAL-të publike. A mendoni se do të jetë efçente kjo zgjidhje?**

Kjo i përket fazës së dytë, asaj të reformimit të një

universiteti të ri. Tani duhet rrëzuar ligji i arsimit të lartë, por që qeveria po tregon se e ka të vështirë sepse ka ngritur një fabulë që na thotë se është një nga ligjet më të suksesshme të saj, por mijëra studentë në rrugë këtë këto ditë dhe qindra maturanë të shkollë këto vitet e fundit tregojnë në kundërtën e fabulës së qeverisë.

**Studentet kanë theksuar se në 7 janar do të rikthehen sërish në protesta. Cilat do të jenë format e protestës suaj?**

Format nuk i di, sepse vendimet merren në shesh në varësi të dinamikave të ngjarjeve. Por e sigurtë është që në datën 7 janar studentët do të jenë përsëri të shumtë e të bashkuar në shesh duke e vazhduar bojkotin e mësimin deri në plotësimin e kërkesave.



TIRANË

Pesë ish-regjistruar të Hipotekës së Kavajës janë kallëzuar në prokurori nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, pasi akuzohen se kanë abuzuar me detyrën. Sipas raportit të KLSH-së, ata kanë kryer regjistrime të pasurive me AMTP pa dokumentacionin e duhur ligjor në sipërfaqe 162851 m<sup>2</sup>, me dokumente të parregullta duke kthyer nga tokë pyll e tokë pa fryt në tokë arë, ndërsa janë kryer tjetërsime të pasurive duke shkaktuar një dëm ekonomik të dukshëm në vlerën 14,490,960 lekë. Gjithashtu, ish-punonjësit e Hipotekës së Kavajës kanë regjistruar objekte me leje legalizimi pa respektuar distancat nga kanali kryesor kullues nga shtrati i detit dhe nga bregu i përroit të Leshnicës.

#### RAPORTI I KLSH-SË

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr.1077/1, datë 17.09.2017, miratuar nga Kryetari, ka audituar Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, për periudhën 01.10.2015 deri në 01.10.2018.

Bazuar në Vendimin nr.193, datë 20.12.2018 të kryetarit, për shkelje të dispozitave ligjore të konstatuara, KLSH ka përcjellë indicie penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë për konsumim të elementëve të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", neni 248 i Kodit Penal, për disa drejtes (pesë ish-regjistruar), sepse:

-Në 2 raste kanë regjistruar pasuritë e paluajtshme, bazuar në akte pronësie, vendimet e KKKP-së, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi janë regjistruar prona të llojit "Pyll" pasi të cilat shërbejnë për interesa publike, në papajtueshmëri me përcaktimet e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për Kthimin dhe Kompenzimin e Pronave Ish-Pronarëve", i ndryshuar dhe ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" ndryshuar e shfuqizuar dhe ligjin nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

-Për moszbatimin dhe mosndjekjen e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, duke mos vendosur kufizime sipas rekomandimeve ose duke i hequr ato, pa dokumente që justifikojnë mosveprimin në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe nenin 59 të ligjit nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

-Në 10 raste ka regjistruar transaksione, duke tjetërsuar tek palët e treta pasuritë, të cilat kanë pësuar ndryshim të zërit kadastral nga "Pyll" në "Tokë arë", për sipërfaqe totale

# Abuzuan me detyrën, KLSH kallëzon në prokurori 5-ish regjistruar të Hipotekës së Kavajës

## Kthyen pyllin në truall dhe legalizuan objekte buzë detit



11440 m<sup>2</sup>, në kundërshtim me përcaktimet ligjore për përfitim të tokës bujqësore, pasi në referencë nuk administrohet dokumentacioni ligjor i plotë që justifikon ndryshimin e zërit kadastral sipas procedurës për miratimin nga Komiteti Ekzekutiv e VKM nr.256, datë 02.08.1991 "Për rregulloren për regjistrimin, ndryshimin dhe kalimin e gjendjes së tokave dhe detyrat e kadastrës", duke i shkaktuar shtetit një dëm ekonomik që llogaritet në vlerën 14,490,960 lekë referuar çmimit sipas kontratës së shitjes.

-Në 4 raste në regjistrimin e AMTP-ve, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, regjistrimet e kryera në regjistra, certifikatës familjare që tregon gjendjen familjare para datës 01.08.1991, si dhe normës për frymë për fshatin Kryemdhënjë zk.2291, rezultojnë se është përfituar më tepër tokë bujqësore sipërfaqen totale 32088 m<sup>2</sup>, në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.

-Për moskalimin në 'shtet' të pasurisë me sipërfaqe 5900 m<sup>2</sup>, ZK 3204 Rrakull, e cila ka pësuar transaksione, pjesëtar në 5 pasuri të reja, ku njëra prej tyre pasuria nr.200/9, me sipërfaqe 2710 m<sup>2</sup>, është shitur gjatë periudhës së auditimit, kur është dorëzuar procesverbal dhe projekt i KLSH, çka bën të pamundur kalimin shtet të saj.

-Për moskalim në 'shtet' të pasurisë 37/3 me sipërfaqe 3040 m<sup>2</sup>, ZK 3501, Spille, sipas vendimit gjykatës, përkundrazit pasuria ka pësuar transaksione kontratë shitje 28.12.2016, ku prona ka

pasur probleme me origjinën "PF" dhe ka një rekomandim nga KLSH në vitin 2014, pra nuk është verifikuar akti administrativ për elementët e formës e përmbajtjes.

-Për heqjen padrejtësisht të kufizimit pa shlyer detyrimin prej 22,250,000 lekë, për subjektin A.H për 7 pasuri ZK 1791 Golem, hequr kufizimin me datë 09.07.2015, mos kufizimin e pasurive dhe lejm transaksione sipas vendimit të KVVTP, i cili i është dërguar ZVRPP me datë 25.04.2016, për regjistrim të pavlefshëmrisë të AMTP 1194 të urdhëruar kthimin me pronarë shtet, për sipërfaqen totale 12792 m<sup>2</sup> moskufizim pasurisë 32/41 për sipërfaqe 1800 m<sup>2</sup> dhe 37/91 për 1584 m<sup>2</sup> në zbatim të vendimit nr.36, datë 28.10.2015 të KVVTP për AMTP 1038 datë 15.09.1995 në kundërshtim me germenin "j", neni 15 të Ligjit Nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 59 të ligjit nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

-Për ndryshimin e zërit kadastral "Pyll" në "Tokë arë" për sipërfaqe 6900 m<sup>2</sup>, pa njohje të titullit të pronësisë nga KVVTP, ku statusi juridik i saj është pyll, çka nuk është objekt i ligjit për shpërndarjen e tokës bujqësore.

-Për ndryshimin e zërit kadastral nga pyll në tokë arë për sipërfaqen 3100 m<sup>2</sup>, pajisur me certifikatë pronësie datë 21.01.2016, sipas urdhrit nr.26, datë 15.01.2016 të ish-regjistruar, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore për përfitim të tokës bujqësore, pasi në referencë nuk administrohet dokumentacioni ligjor i plotë që

justifikon ndryshimin e zërit kadastral.

-Për regjistrimin e pasurive nr.11/5, ZK. 3501-Spille, Kavajë, për 860 m<sup>2</sup> "pemëtores", 200 m<sup>2</sup> "Truall" dhe 80 m<sup>2</sup> "ND" dhe Pasuria nr. 40/17, ZK. 3501 Spille, Kavajë, për 3600 m<sup>2</sup> "Arrë", në emër të Tefta Mërtiri në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi Lista Emërore e Pronarëve të Trojeve dhe Shtëpive me nr. 0001 për Rrethin Kavajë, ZK 3501, Spille nuk ka të regjistruar pronë në emër të T.M, por për Parcelën nr. 11/5 me "Truall" me sip.200 m<sup>2</sup> dhe sip. 80 m<sup>2</sup> është në emër Th.T.G gjithashtu AMTP me nr.1831 datë 15.04.1996 e administruar nga ZVRPP Kavajë nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes.

-Në 8 raste në regjistrimin e lejeve të legalizimit nga verifikimi i materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës rezultojnë se ZVRPP Kavajë ka regjistruar me të meta dhe mangësi pasuritë pasinë 3 raste nuk janë respektuar distancat nga kanali kryesor kullues, nga shtrati i detit dhe nga bregu i përroit të Leshnicës, në 3 raste regjistrimi i "truallit" mbi të cilën është ndërtuar objekti informal i legalizuar sipas lejes së legalizimit është në pasurinë bazë me status "Pyll" në pronësi "Shtet", në një kohë që kompetenca për ndryshimin e zërit kadastral i takon ministrit apo organeve të tjera të përcaktuara në ligj, në një rast objekti është ngritur në zonën "Brez i Gjellër" të kategorizuar me Vendim të KRRTRSH nr.2, datë 18.06.2013 dhe Zonë S të kategorizuar me Vendim nr.38, datë 10.05.2013 të KRRTRSH.

-Në 1 rast për pasurinë nr.

373/54, vol. 17, fq. 187, zk. 2291, me sipërfaqe 7200 m<sup>2</sup>, ka vijuar duke regjistruar kalimin e pronësisë nga pronari shtet tek shtetasi R.D sipas AMTP, pa verifikuar më parë elementët e formës dhe përmbajtjes të aktit, në kundërshtim me Vendimin nr.3026, datë 06.10.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që ka vendosur kthimin në shtet ta pasurisë nr.373/54, zk.2291, me sipërfaqe 7200 m<sup>2</sup>, pasi kjo është përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

-Për ndryshimin e zërit kadastral nga pyll në truall, Qerret, Kavajë, çka ka degraduar brezin mbrojtës pyjor, sipërfaqen e gjelbër me pisha, në dëm të zonës turistike bregdetare, pasi mbi këto pasuri janë kryer ndërtime me leje legalizimi (16600 m<sup>2</sup>), me leje ndërtimi për veprimtari turistike nga shoqëri të stimuluar (28853 m<sup>2</sup> E... shpk., dhe E...shpk. etj., ku statusi juridik i tokës ka qenë pyll.

-Për ndryshim të zërit kadastral pyll në tokë arë për sipërfaqen 3000 m<sup>2</sup>, pasuria 14/55, ZK 3101, Qerret, Kavajë, e cila është përfituar padrejtësisht nga subjekte private me AMTP dhe më tej pasuria ka pësuar transaksione, mbi të me leje ndërtimi është ngritur palat "4-kat+parafino".

-Për ndryshim të zërit kadastral "rrugë e kullota" e kthyer në "arë" për sipërfaqen 2850 m<sup>2</sup>, e cila është përfituar padrejtësisht me AMTP, prona më tej ka pësuar transaksione deri tek pallati "Qendër turistike 4-kate, Golem" me leje ndërtimi 27.5.2005, pasuria 64/12 dhe 64/15, ZK 1791, sipas referencave 1823, 1824, 1915, 2623, 3394 viti 2004-2006, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore për përfitim të tokës bujqësore, pasi në referencë nuk administrohet dokumentacioni ligjor i plotë që justifikon ndryshimin e zërit kadastral.

-ZVRPP Kavajë, për pasurinë nr.1/3, me sipërfaqe 502200 m<sup>2</sup> "pyll", vol 3, faqe 190, ZK 3101, Qerret, në mënyrë të pa argumentuar ka bërë 18 kallime nga një volum në një tjetër, nga vol 3 deri tek 20, ka kryer ndarje të pasurisë, si rezultat i ndërtimeve me leje ndërtimi për veprimtari turistike nga shoqëri të stimuluar (28853 m<sup>2</sup> E...e E...), i vendimeve të VKKP (135500 m<sup>2</sup>), i ndër-

timeve me leje legalizimi (16600 m<sup>2</sup>) dhe i qiradhënieve (4975 m<sup>2</sup> V.... shpk.), duke ndryshuar zërin kadastral nga pyll në truall dhe në ndërtësë për sipërfaqen gjithsej 193020 m<sup>2</sup>, çka ka degraduar brezin mbrojtës pyjor, sipërfaqen e gjelbër me pisha, në dëm të zonës turistike bregdetare, pasi nga 502200 m<sup>2</sup> pyll në vitin 1997 kanë mbetur 309180 m<sup>2</sup> "PF + Pyll" në 2017.

-ZVRPP Kavajë ka regjistruar 2 lejet e legalizimit në kushtet e mungesës të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe nuk ka ndjekur dhe zbatuar procedurat gjatë shqyrtimit nga KVVTP të njohjes të titullit të pronësisë të AMTP 943 datë 18.02.1995 në emër të I.Z, por ka kryer transaksione me pronën, kanë kryer veprime mbi pasuritë nr. 102/23+1-1, 102/23 +1-2 dhe 1/258 dhe pasuritë e tjera vijuese duke regjistruar ndërtesa që ndodhen mbi ish-sipërfaqet me pisha në bregdetin Qerret, Golem, për të cilat janë dhënë leje ndërtimi për veprimtari turistike të stimuluar dhe jo për shtëpi banimi.

KLSH i ka kërkuar kryerregjistruar në Zyren Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore për 6 punonjës: P.P. me detyrë Specialist Jurist, A.M. me detyrë Specialist Jurist, E.C me detyrë Hartograf, I.C. me detyrë Jurist, A.C. me detyrë Juriste dhe F.M. me detyrë specialist hartograf.

Për S.C., me detyrë ish-regjistruar, F.M., me detyrë ish Regjistruar, A.Q., me detyrë ish Regjistruar, F.G., me detyrë ish Regjistruar, A.M. me detyrë ish Regjistruar, D.K. me detyrë ish-Specialist Hartograf, të cilët në mospërbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, KLSH ka përcjellë indicie penale pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.

## VRASJET E GRAVE REAGIMET

Almeida Xhaferi: Duhet formësuar skema të shëndetshme mendore për problemin

# Psikologjia: Vrasja e grave, strehë në patriarkalitetin shqiptar

"Femra, objekt pronësor i burrave në vendin tonë"

Voltiza Duro

Gratë e vajzat shqiptare, jo pak herë bien pre e dhunës nga bashkëshortët, partnerët apo baballarët e tyre, dhunë e cila në disa raste ka degjeneruar deri në vrasje. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', psikologjia klinike, msc. Almeida Xhaferi thekson se ky problem ka rrënjë të thella kulturore e gjen strehë në mënyrë patriarkale. Sipas psikologes gjithmonë flitet për faktorë risku ku mund të përmendet një e kaluar me precedent penal, përdorimi i substancave narkotike dhe alkoolit, mbajtja e armëve, probleme sociale, të rriturit në një ambient të dhunshëm apo neglizhuës etj. Xhaferi shton se ka shumë burra në Shqipëri që kanë bindjen se gruaja ju përket si pronë, të cilën nëse nuk e gëzojnë ata, askush tjetër nuk mund ta ketë. Më tej, gratë përshkruhen si provokatore të situatave të dhunës nga ana e partnerëve të tyre. Sipas psikologes modeli i marrëdhënies burrë-grua është ndërtuar i deformuar në konceptet e tyre e shihet si një raport varësie, ku burri vendos dhe gruaja bindet, në rastet kur kjo pritishtëri nuk përmbushet burrat ndjehen të pafuqishëm dhe konsiderojnë aktin e dhunës si një instrument që do detyrojë partneren, të përmbushë dëshirat e burrit.

Ky vit i ri është përgjakur nga vrasja e dy motrave në Ballsh si dhe nga një tjetër vrasje në Greqi ku babai ka vrarë dhe varrosur në oborr të bijën 28 vjeçare. Cili është koment i juaj si psikologe mbi këto ngjarje që tronditën opinionin publik ditë e para të 2019-ës?

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një problem me rrënjë të thella kulturore, i cili gjen strehë në një shoqëri seksiste si kjo e jona. 2019 na gjeti duke përjetuar hidhërim të thellë, për shkak se një 17 vjeçare u vra nga dora e një 19 vjeçari, ende pa na lënë



Psikologjia klinike, Msc/Almeida Xhaferi

### MENTALITETI

Për fat të keq jetojmë ende në një shoqëri patriarkale ku burrat pretendojnë se kanë privilegje që gratë nuk duhet t'i kenë.

Dhuna strehohet pikërisht në shoqëri si kjo, që karakterizohet nga dominimi mashkullor.

### BILANCI I GRAVE DHE VAJZAVE TË VRARA NË 2018-2019

- 20 janar 2018, vritet pranë Fakultetit të Mjekësisë, studentja 22 vjeçare A. M në Tiranë.
- 21 janar 2018, vritet në shtëpinë e saj, 73 vjeçaria S. H në qytetin e Vlorës.
- 5 prill 2018, vritet Z. T, 68 vjeçe, nëna e 6 fëmijëve në shtëpinë e saj.
- 27 prill 2018, vritet në shtëpinë e saj, gruaja S.SH, 58 vjeçare në Shkodër.
- 27 maj 2018, vritet 52 vjeçaria E.T në shtëpinë e saj, pas shumë goditjeve vdekjeprurëse.
- 30 maj 2018, vritet në automjetin e saj, 34 vjeçaria, F.N, madje në sy të fëmijës së mitur.
- 7 qershor 2018, vritet në shtëpinë e saj nga djali, nëna 50 vjeçe, Z.S në Peshkopi.
- 8 qershor 2018, vritet në shtëpi, 40 vjeçaria, A.Sh, nëna e 6 fëmijëve.
- 9 qershor 2018, duke shkuar në shkollë për të, vritet në mes të rrugës 18 vjeçaria XH. Ç.
- 10 qershor 2018, vritet dhe hidhet në rrugë, trupi i 20 vjeçares, A. M.
- 4 korrik 2018, vritet në banesën e saj 61-vjeçaria S. L. në Elbasan.
- 15 korrik 2018, vritet në Shkodër pranë fëmijës 1 vjeçe, S.N vajza 25 vjeçare.
- 10 gusht 2018, vritet Perrie Zykaj, 78 vjeçe, Vasili Zykaj 40-vjeçe, Sara Zykaj, 15 vjeçe dhe Afërdita Zykaj 47-vjeçe.
- 02 janar 2019, vritet në Ballsh Gentiana Caushaj 34 vjeçe dhe motra e saj, Merisa Caushaj 18 vjeçe.
- 02 janar 2019, vritet Angelina Petro, 29 vjeçe në Korfuz, Greqi nga babai i saj.

kohë për të përpunuar këtë zi shpirtëror, një tjetër tragjedi ndodh këtë herë në Ballsh, ku një 31 vjeçare dhe një 18 vjeçare vriten. Tre gra të vrara nga dora e burrit apo shokut të tyre në një cikël të shkurtër kohor, më pak se 10 ditë. Ngjarje të rënda që mbushën kronikat e lajmeve dhe tronditën opinionin publik.

**Cfarë portreti psikologjik kanë burrat e dhunshëm, të cilët në prani të konflikteve banale, arrijnë deri në ekzekutimin e partnerëve?**

Në fushën e psikologjisë janë bërë hulumtime të shumta për të parashikuar se cilat karakteristika psikologjike nxisin kryerjen e krimeve kundër grave, por ende sot nuk kemi një profil psikologjik të qartë të vrasësve. Gjithmonë flitet për faktorë risku. Këtu mund të

përmendim një të kaluar me precedent penal, përdorimi i substancave narkotike dhe alkoolit, mbajtja e armëve, probleme sociale, të rriturit në një ambient të dhunshëm apo neglizhuës etj. Ne duhet të kemi parasysh se dhuna është një problem kulturor që në disa raste shoqërohet me edhe nga probleme të natyrës psikologjike, si dhe me simptomatologji ankthi, depresioni apo probleme organizative të strukturës së personalitetit.

**Bazuar në këto sjellje, a mund të pohojmë se burrat shqiptarë kanë tendencën të jenë dominantë ndaj grave?**

Për fat të keq jetojmë ende në një shoqëri patriarkale ku burrat pretendojnë se kanë privilegje që gratë nuk duhet t'i kenë. Dhuna strehohet pikërisht në shoqëri si kjo, që karakterizohet nga domini-

mi mashkullor. Në gjykimin tim ne duhet të fillojmë të edukojmë fëmijët tanë të shprehin dhe përballojnë ndjenjën e vetmisë, zemërimit dhe humbjes, pasi vetëm kështu ne investojmë në formësimin e shëndetshëm të afektit, duke rritur një brez me aftësitë e nevojshme për të përballuar shëndetshëm këto ndjenja për të cilat ne flasim shumë pak, pasi dëshirojmë të mos përballemi kurë me to. Rruga e shëndetshme është të formësojmë skema të shëndetshme mendore për t'i kapërcyer ato.

**A ndikojnë modelet brenda familjes në zhvillimin e sjelljeve të dhunshme të burrave në të ardhmen?**

Nga ana tjetër degjojmë shumë të flitet për burra që kryejnë papritur vrasje brenda familjes, por nuk ndalemi asnjëherë të faktorët e disfa-



vorshëm socio-kulturorë, për shembull, djem që rriten në familje të dhunshme, ku gratë janë trajtuar gjithmonë, si objekte pronësore të burrave, ku këta të fundit ndjehen të pavlerë, të pa përgatitur dhe të pafuqishëm, përballë argumenteve, fakteve, apo dëshirës së grave për të qenë të lira dhe të realizuara në jetën e tyre. Në mungesë të modeleve të shëndetshme prosociale burrat e shohin ekzekutimin e partnerëve si zgjidhje për të mos tu ndjerë të braktisur. Janë burra që kanë bindjen se gruaja ju përket si pronë, të cilën nëse nuk e gëzojnë ata, askush tjetër nuk mund ta ketë. Ne duhet ta shohim çdo akt dhune si një dhimbje të madhe, ku mungon aftësia për ta shprehur atë, përveçse me dhunë, goftë kjo dhunë fizike, verbale apo psikologjike. Gratë përshkruhen si provokatore të situatave të dhunës nga ana e partnerëve të tyre. Shpesh ata shprehen se ndjehen të parespektuar, dhe të pavlerësuar, pasi modeli i marrëdhënies burrë-grua është ndërtuar i deformuar në konceptet e tyre. Shihet si një raport varësie, ku burri vendos dhe gruaja bindet, në rastet kur kjo pritishtëri nuk përmbushet burrat ndjehen të pafuqishëm dhe konsiderojnë aktin e dhunës si një instrument që do detyrojë partneren, të përmbushë dëshirat e burrit.

**Cilat janë disa prej faktorëve kryesorë që i çojnë burrat deri në vrasjen e bashkëshorteve, partnerëve apo vajzave të tyre?**

Ne habitemi kur degjojmë tragjedinë që ndodh, të njohurit shprehen se ishin familje qetë, pasi gruaja nuk e merr guximin ta denoncoj dhunën, që në momentin e parë, kjo për disa arsye së pari mungon suporti i familjarëve, ata nuk ja hapin dyert grave që kërkojnë të ndihen, pasi opinion i vret. Së dyti, për shkak të modeleve të papërshtatshme këto gra dhe vajza rriten me idenë se burri duhet të ven-

dosë për to, madje pas zjyrtarizimit të marrëdhënies ato i përkasin tërësisht burrit. Së treti, pavarësia ekonomike e vështirëson të gjithë procesin e zgjidhjes së martesës. Kur vrasja ndodh ka dhënë patjetër sinjale, të cilave nuk i është kushtuar rëndësia e duhur.

**Përpapa se të ushtrojnë dhunë fizike çfarë sinjalesh jep burri?**

Ekziston një cikël dhune, që parashikon një fazë tensionesh psikologjike mes çiftit të përbërë nga humori i keq, momentet e heshtjes, konfliktet e njëpasnjëshme, zhvlerësimi i gruas, përbuzje, kërcënime, pastaj ndodh dhuna fizike.

**Sipas jush si mund të frenohet ky fenomen?**

Së pari të gjithë ata prindër dhe familjarë që kanë dëni se vajza apo motra e tyre është pjesë e një cikli dhune, nuk duhet të heshtin, por të konsiderojnë sinjalet e alarmit që shfaqen; të reagojnë përpapa se krimi të ndodhë dhe të ofrojnë mbështetje morale dhe sociale për gruan që gjendet në situatë kritike. Së dyti, të referohen dhunuesit për tu trajtuar psikologjikisht, në qendra që ofrojnë shërbime këshillimi për burrat që dhunojnë gratë. Trajtimi psikologjik duhet parë si një mjet shumë efikas për të parandaluar vrasjet e grave.

**Cfarë do sillnin ndryshes konsultat me psikologët?**

Konsultat me psikologun në thelb in e tyre janë procese degjimi pa gjykuar, por ftojnë burrat të pranojnë se janë përgjegjës kryesor për aktet e tyre dhe nxitin të angazhohen të mos reagojnë më në mënyrë të dhunshme. Bëhen seanca ku flitet për dhunën dhe punohet që burrat të njohin sinjalet që po fillojnë të humbin kontrollin të vetja, si pasojë e zemërimit. Në fokus të punës është rindërtimi i skemave mendore prosociale, të cilat ndihmojnë individin të përballtet me problemet e përditshme pa përdorur dhunën për të kapërcyer ndjenjat e të ndjerit të pafuqishëm, apo të pa vlerë.





Emisioni për shqiptaren e vrarë në "Skai TV"

## Bashkëpunëtor i serbit të tmerrshëm, arrestohet shqiptari

**ITALI** - Afrim Bejzaku nga Kosova është vënë në pranga nga policia italiane në provincën e Ferrarës, pasi konsiderohet si bashkëpunëtor i një grupi kriminal. Mësohet se Bejzaku është pjesë e grupit të serbit të tmerrshëm i njohur si "Igor Rusi". Ai njihet ndryshe edhe me emrat Igor Vlacovic apo Norbert Feher, ndërsa aktualisht vuan dënimin me burg në Spanjë me akuzën e 5 vrasjeve. Igor Vlacovic u arrestua në Spanjë në dhjetor të vitit 2017-ës, pas disa muajsh i shpallur në kërkim ndërkombëtar. Ai është autori i vrasjes së dy personave në Itali gjatë grabitjeve me armë si dhe të 3 personave në Spanjë, mes të cilëve edhe dy punonjës policie. Shqiptari Afrim Bejzaku, 37 vjeç, rezultoi i dënuar më herët nga Prokuroria e Rovigos me 2 vjet e 3 muaj burg me akuzën e grabitjeve të kryera në rajonin e Venetos. Sipas hetimeve, Afrim Bejzaku nuk rezultoi të ketë lidhje me vrasjet e kryera nga "Igor Rusi", por ai ka qenë pjesë e bandës "Pajdek", grup kriminal i specializuar në grabitje, ku bënte pjesë edhe "Igor Rusi".



## Eksplodiv bankomatit, hajdutët marrin 5 milionë lekë

**URA VAJGURORE** - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, persona ende të paidentifikuar kanë shpërthyer me eksploziv një bankomat në Urën Vajgurore, ndërsa kanë marrë një shumë parash. Mësohet se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:24, ndërsa shuma e grabitur është 5 milionë lekë të vjetra. "Më datë 04.01.2019, rreth orës 02:24, në Urën Vajgurore, është konstatuar nga shërbimet e Patrullës së Përgjithshme, se është shpërthyer dhe vjedhur bankomati i një banke të nivelit të dytë, ku kanë marrë një sasi lekësh. Grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes si dhe kapjen e autorëve", thuhet në njoftimin e policisë.



"Skai" jep kronikën e "News 24". Qeni besnik zbuloi vendin ku ishte groposur viktimja


# Vrasja makabre e Angjelina Petros, mjekja ligjore: Babai e goditi 7 herë me shufër hekuri

"Krimi brutal, vajza ngriti duart lart të mbrohej"

GREQI

**V**rasja makabre e 29-vjeçarës shqiptare Angjelina Petro nga i ati ka tronditur Greqinë. Ngjarja e rëndë e ndodhur mbremjen e 2 janarit në Korfuz ka zënë faqet e para në mediat e vendit fqinj. Kjo ngjarje është trajtuar gjerësisht në emisionin "Mazi sou" (Me ty) të gazetares së njohur greke, Tatiana Stefanidhu në "Skai TV". Gazetarë, analistë dhe specialistë të krimeve zbardhën ngjarjen e rëndë, duke sjellë detaje të reja dhe domethënës rreth saj. Në lidhje direkte nga fshati ku jetonte Angjelina, gazetarja tregoi se më 1 janar, i dashuri afgan i vajzës dhe 2 prindërit e tij grekë, të cilët e birësuan që të vogël kur lufta e la pa prindër, së bashku me djalin e shoqëruan viktimën në shtëpinë e të atit dhe e lanë që ta merrnin sërish disa orë më vonë, duke e ditur se marrëdhënia mes të dyve nuk ishte e mirë. Pak orë më vonë, gjatë një telefonate, i dashuri dëgjoi sherrin që Angjelina po bënte me të atin, Aleko Petro dhe më pas nuk u lidh dot më, pasi telefoni ishte i mbyllur. Në mëngjes fqinja e viktimës, që jeton në shtëpinë pranë, gjeti celularin e vajzës dhe së bashku me të dashurin lajmëruan policinë. Gazetarja tregon se gjatë sherrit vajza ishte hedhur nga dritarja në 2 metra lartësi për t'i shpëtuar të atit. Por, babai vrasës e ndoqi me vrap me shufër e hekuri në dorë, e kapi në kopsht, ku i dha goditjet fatale dhe në të njëjtin vend e varrosi.

**ZBULIMI I KUFOMËS**  
Kamerat e televizionit tregonin qenin e Angjelinës. Rokin, që shkonte vazhdimisht në vendin ku atë natë të errët u gropos vajza dhe kthehej sërish në shtëpi. Madje, tri ditë më parë ishte ai që drejtoi policët pikërisht aty ku u zbulua krimi makabër. Fqinja greke që ishte bërë edhe kumbara e Angjelinës, një grua që e mori nën mbrojtje 29-vjeçarën shqiptare, e përshkroi atë si "një vajzë e ngjallë". Në emision u transmetua edhe kronika e "News 24" me dëshminë dhe apelin e nënës së Angjelinës. Gazetari Mario Aravandinos falënderoi televizionin "News 24" për këtë bashkëpunim. "Do të ndjekim tani një reportazh të realizuar nga televizioni 'News 24', një televizion i



29-vjeçarja e vrarë, Angjelina Petro

## MJEKJA LIGJORE

"29-vjeçarja është goditur të paktën 7 herë në kokë me shufër e hekuri. Nga këto goditje vihet në tension, urrejtje. Duket se viktimja ka ngritur duart për të mbrojtur fytyrën, vazhonte ta qëllonte edhe në duar. Pastaj ky prind pastroi shtëpinë nga gjakrat, fshehu sendet personale dhe e varrosi në kopsht. Si mundet një prind të jetë kaq gjakthotë para një akti të tillë? Kjo vrasje më ka lënë pa fjalë, nuk ishte thjesht një incident, ishte shumë e egër, shumë brutale", ka thënë mjekja ligjore, Hrisavgi Kushi për median greke.

## AVOKATI I VRASËSIT

Avokati i vrasësit, Vasilis Nulezas, duke mbrojtur klientin e tij, tha se babai shqiptar po e vuan shumë këtë ngjarje dhe se vrasja ka ndodhur në tension e sipër, pasi vajza e kishte përjashtuar nga jeta e saj. Mes të tjerash, avokati u shpreh se 57-vjeçari kishte një dashuri patologjike për vajzën. "Media përshkruan gabim tiparet e vrasësit. Vajza i kërkonte që mos të ndërhynte shumë në jetën e saj. Viktimja ishte larguar nga nëntori i 2017-ës nga shtëpia për të jetuar e pavarur, pa e informuar për jetën që bënte", ka thënë Nulezas.

madh informativ në Shqipëri, i cili arriti të marrë dëshminë e nënës së Angjelinës. Falënderojmë kolegët e mirë shqiptarë që na ndihmuan me këtë reportazh, për të plotësuar më së miri tablonë e kësaj ngjarjeje të rëndë", u shpreh Aravandinos. "Shikoni sa e varfër është nëna, shikoni këtë grua që nuk e ka parë fëmijën e saj kaq vite. E kërkon trupin e vajzës ta qajë në shtëpinë e saj të varfër". Në këtë kontekst gazetarja bëri thirrje që qytetarët ta ndihmojnë atë. Pa një diskutim të gjatë për rrethanat dhe shkaqet që shtynë një 57-vjeçar t'i marrë jetën vajzës së tij, duke theksuar se krimi nuk ka etni, drejtuesja e emisionit e mbylli me fjalët: "Erzhi në Korfuzin e bukur për një jetë më të mirë, tek një baba i panjo-

hur deri atëherë, të idealizuar në mendjen e saj, i cili e trajtoi barbarisht, siç thanë dëshmitarë e miq të vajzës. Erzhi për një jetë më të mirë me babanë që ëndërronte dhe që përfundimisht e vrau". Krimi nuk ka etni kanë theksuar dhe gazetarët e tjerë, madje Hrisia Gjeorgakopulu ka kundërshtuar avokatin mbrojtës të vrasësit gjatë bisedës 'live', kur ky i fundit ka dashur të justifikojë aktin me mentalitetin e shoqërisë së dhunshme shqiptare. "Jo, nuk e pranoj, doni të thoni që shqiptarët nuk i duan fëmijët e tyre? Jo, nuk qëndron ky justifikim", ka reaguar ashpër gazetarja, duke e ndërprerë avokatin, i cili në vijim i detyruar ka ndryshuar tonin e bisedës.

## EKSPERTIZA

Mjekja ligjore, Hrisavgi Kushi në Korfuz ka folur për një vrasje brutale të 29-vjeçarës Angjelinë Petro nga babai në Korfuz. Ajo ka thënë se vajza është goditur 7 herë me një shufër hekuri

## TELEFONATA

Më 1 janar, i dashuri afgan i vajzës dhe 2 prindërit e tij grekë, të cilët e birësuan që të vogël kur lufta e la pa prindër, së bashku me djalin e shoqëruan viktimën në shtëpinë e të atit dhe e lanë që ta merrnin sërish disa orë më vonë, duke e ditur se marrëdhënia mes të dyve nuk ishte e mirë. Pak orë më vonë, gjatë një telefonate, i dashuri dëgjoi sherrin që Angjelina po bënte me të atin, Aleko Petro dhe më pas nuk u lidh dot më, pasi telefoni ishte i mbyllur.

dhe i kishte duart lart si për t'u mbrojtur. Mjekja ka deklaruar se është shokuar nga ato që ka parë dhe se ky krim nuk ka qenë një incident, por një vrasje e egër. "29-vjeçarja është goditur të paktën 7 herë në kokë me shufër e hekuri. Nga këto goditje vihet në tension, urrejtje. Duket se viktimja ka ngritur duart për të mbrojtur fytyrën, vazhonte ta qëllonte edhe në duar. Pastaj ky prind pastroi shtëpinë nga gjakrat, fshehu sendet personale dhe e varrosi në kopsht. Si mundet një prind të jetë kaq gjakthotë para një akti të tillë? Kjo vrasje më ka lënë pa fjalë, nuk ishte thjesht një incident, ishte shumë e egër, shumë brutale", ka thënë mjekja ligjore për median greke. Ndërkas, avokati i vrasësit, Vasilis Nulezas duke mbrojtur klientin e tij, tha se babai shqiptar po e vuan shumë këtë ngjarje dhe se vrasja ka ndodhur në tension e sipër, pasi vajza e kishte përjashtuar nga jeta e saj. Mes të tjerash, avokati tha se 57-vjeçari kishte një dashuri patologjike për vajzën. "Media përshkruan gabim tiparet e vrasësit. Vajza i kërkonte që mos të ndërhynte shumë në jetën e saj. Viktimja ishte larguar nga nëntori i 2017-ës nga shtëpia, për të jetuar e pavarur, pa e informuar për jetën që bënte. Këtë nuk e duronte dot klienti im, besoj se është çështje e psikologjisë së tij, nuk kishte ushtruar dhunë më parë, e donte vajzën e tij. Është i dërrmuar psikologjikisht dhe nuk besoj se do ia dalë mbanë me procesin gjyqësor. Nuk ishte vrasje me paramendim, ndodhi në tension e sipër, pas një debati të ashpër", pohoi avokati.

## INTERVISTA

# IDEATORI I ÇMIMIT

## Edi Muka: Paqëndrueshmëria e skenës së artit dhe pse mbyllëm "Onufrin"

Fatmira Nikolli

Ajo që ka rëndësi jetike është të të mos humbet pasioni, i cili në kushtet e paqëndrueshmërisë së mbështetjes institucionale mbetet motori i vetëm që mund të mbajë gjallë përpjekjet për të vazhduar... Ajo që i ka munguar skenës dhe që po fillon të ravijëzohej është ndjesia e intimitetit dhe qashtërsisë...

Viti 1998. Kuratori Edi Muka dhe Gëzim Qendro (atëkohë drejtor i GKA) ideojnë dhe propozojnë çmimin ndërkombëtar dhe ekspozitën "Onufri". Ministër Kulturë ishte Edi Rama. Synimi ishte hapja e skenës artistike shqiptare ndaj botës. 20 vite më vonë, në 24 dhjetorin e 2018-ës, Galeria Kombëtare e Arteve, ditën kur ekspozita duhej të ishte e celur, përmes një deklarate për mediat njofton se "Onufri" është mbyllur. Debatit në Tiranë zhvillohej prej më shumë se një muaji, por GKA nuk kishte reaguar deri më 24 dhjetor. Njoftimi rendiste 'dëshitimet' vit pas viti dhe faktin që e kishte humbur qëllimin fillestar:

"Gazeta Shqiptare" është përpjekur të intervistojë të gjithë anëtarët e bordit të GKA-së për të sqaruar vendimin e marrë dhe arsyet që çuan deri aty. E para që pranoi të fliste ishte Eleni Laperi, kryetare e bordit. Ndërsa sot, vjen në "GSH", Edi Muka, një prej atyre njerëzve që e kanë shndërruar skenën e artit pamor në vend ndër vite; një prej ideatorëve të "Onufrit" dhe një prej anëtarëve të bordit që e mbyllën "Onufrin". Intervista është realizuar me e-mail dhe në të, Muka ndalet gjatë, pyetje pas pyetjeje, për të shpjeguar Tiranën e artit sot, paqëndrueshmërinë e saj, GKA-në e Onufrin në sytë e tij. "Shoqëria jonë ende lëngon në një gjendje të ndërmjetme pa arritur të ndërtojë ndërgjegjen qytetare dhe ndjesinë e kolektivitetit pozitiv, ku njerëzit të ndërgjegjësohen se kemi më shumë gjëra që na bashkojnë si komunitet sesa na ndajnë si individë". - thotë Muka, duke shtuar se "interesante kohë e fundit, është lindja dhe zhvillimi i iniciativave idealiste". Përtej faktit që nuk është një "inter-view" e gazetarit me kuratorin, ballë për ballë, Muka,

*Ekspozita ndërkombëtare mbahej në GKA, Muka vjen në një vështrim për artin, politikën artistike dhe shoqërinë*

vjen me një vështrim të thellë: përfutur në distancë për Tiranën e artit sot.

**Ndërr vite në Tiranë keni organizuar aktivitete artistike që kanë tërhequr emra dhe publik. Mbyllja e "Onufrit" ka shkaktuar pakënaqësi mes artistëve. Çfarë e bëri Mukën të mendojë se "Onufri" duhet mbyllur?**

Pak a shumë mendimet tona janë shprehur në njoftimin e shpërndarë nga Galeria. Por për të kuptuar këtë vendim është e nevojshme të rikujtojmë e të njohim pak historinë e Onufrit. Unë dhe Gëzim Qendro, drejtor i GKA në 1998, ishim ata që ideuan dhe propozuan kthimin e Onufrit në një çmim ndërkombëtar dhe ekspozitë të kuruar gjatë kohës kur kryeministri i sotëm ishte ministër kulturë. Për mua personalisht Onufri është një ngjarje me tepër peshë, sepse shënon hapjen e skenës shqiptare ndaj botës, por dhe hapjen e horizontit të punës time si kurator. Natyrisht që propozimi nuk u prit mirë dhe hasi shumë kundërshtitë, ashtu siç ndodh me çdo risi që sjell ndryshime rrënjësore. Por për mua ky propozim vinte si një kërkesë urgjente e kohës që korrespondonte me lindjen skenës së artit bashkëkohor në Shqipëri dhe nevojën

### SHOQËRIA E ARTI

Politika dhe shoqëria vazhdojnë të dominohen nga dhuna, verbale dhe fizike, dhe modeli i vetëm i pranuar si mishërimi i suksesit është njëshi, i forti, maskulli. Për këto arsye dhe shumë të tjera, nuk është e lehtë që këto situata të mund t'i artikulojnë estetikut. Për më tepër, ky fragmentizim i shoqërisë pasqyrohet dhe në skenën artistike, e cila, gjithashtu, është e polarizuar, e ndikuar politikisht dhe për më tepër mosbesuesë në raport me institucionet

për të ndërtuar urat e munguara të komunikimit me botën. Natyrisht që me kalimin e viteve dhe përvojën e fituar, duke reflektuar mbi luhatjet dhe paqëndrueshmërinë e nivelit të edicioneve të Onufrit unë kuptova se problemi i kësaj paqëndrueshmërie ka lidhje me dy aspekte. Aspekti kryesor ka të bëjë me formatin e organizimit të veprimtarisë. Onufri organizohet me një format hibrid që përmban disa elemente të cilat nuk përputhen me njëri-tjetrin. Kjo vjen si pasojë e trashëgimit të disa prej tyre nga koha kur Onufri ishte veç një çmim kombëtar për pikturë, skulpturë e grafikë, një veprimtari që u krijua me nxitim për të zëvendësuar ekspozitën kombëtare të përvjetorit të çlirimit (kjo është dhe arsyeja pse "Onufri" mbahet në fund të vitit). Ndryshimi i statutit të "Onufrit" në ekspozitë ndërkombëtare e të kuruar u bë nën tryshninë e domosdoshmërisë, të mungesës së kohës së nevojshme për strukturim si dhe në kushtet jo-normale socio-politike (mjaft të përmend se "Onufri" i parë u mbajt vetëm 2 muaj pas përpjekjes dy-ditore për grusht shteti në vitin 1998). Por më duhet, gjithashtu, të them se ai edicion i parë u realizua me një proces të plotë kërkimi kuratorial. Unë nuk u takova apo pranova propozime vetëm nga artistë shqiptarë, por si pjesë e kërkimit unë udhëtova në të gjitha vendet e Ballkanit dhe në Turqi, ku pata vizita në studio e takime me artistë, nga të cilët më pas përzgjedha pjesëmarrësit e atij edicioni. Por për t'u rikthyer tek problemet, siç po shpjegoja, në konstitucionin e Onufrit ndërkombëtar u trashëgua struktura e çmimit e ndërthur me formën e ekspozitës së kuruar. Një nga arsyet e ruajtjes së çmimit ishte strategjia për të ftuar juri profesioniste ndërkombëtare, si një formë takimi mes skenës shqiptare dhe kuratorëve ndërkombëtarë. Por natyrisht që ky format ishte problematik, sepse nuk mund të punohet me një ekspozitë të kuruar dhe të japësh çmim për artisten më të mirë brenda saj, e për këtë ne nuk reflektuam as e si duhet që në fillim.

Fakti që Onufri u ruajt në vite

dhe u zhvillua edhe nga ata që ishin disa nga kritikët më të egër të kthimit të tij në ekspozitë ndërkombëtare e të kuruar, por edhe reagimet e artistëve që përmendni ju, janë dëshmia më e mirë që krijimi i "Onufrit" si platformë shkëmbimi ishte vendimi i duhur që solli ndërkombëtarizimin dhe madje dhe zhvillimin e skenës shqiptare në atë që është sot. Por ajo që kam vërejtur gjatë viteve është vazhdimi i mungesës së reflektimit ndaj problemeve strukturore të veprimtarisë, e cila vazhdoi të zhvillohej mbi të njëjtat baza, pa asnjë qasje apo analizë kritike që ndoshta do të kish mundësuar ndryshime që më herët. Ai proces kërkimi që përmenda më lart dalëngadalë u harua dhe u braktis fare në edicionet në vazhdim. Kjo solli pabarazi në marrëdhënien mes artistëve shqiptarë dhe të huaj, si dhe paqëndrueshmërinë e nivelit të Onufrit, ku herë çmimi e herë kurimi bëheshin kurban vetëm për hir të realizimit të edicionit të radhës. (Paradoksisht titulli i edicionit të parë të Onufrit që unë kurova ishte "Paqëndrueshmëri e Përherëshme"). Natyrisht që niveli i ekspozitës ndikohet edhe nga niveli i organizimit, kurimit, kujdesit e seriozitetit. Por për mua problemi kryesor dhe deformimet që erdhën mbartan nga formati i "Onufrit". Mospërputhja mes çmimit dhe ekspozitës së kuruar krijon një marrëdhënie e panatyrshme që i hap rrugë deformimeve që kemi parë në vite. Pra, ose do të ruhet çmimi dhe do të sakrifikohet ekspozita e kuruar ose anasjelltas. Mes këtyre të dyjave unë mendoj se roli i GKA është të punojë me programe e platforma kërkimore që rezultojnë në ekspozita të kuruara me përfshirjen e artistëve vendas e të huaj, ç'ka e përjashton bashkëzotuesin e një çmimi. E në këtë zgjedhje nuk ka vend për formatin ekzistues e për rrjedhojë as për emrin e veprimtarisë, i cili shkon bashkë me çmimin.

Tregu i artit e kulturës në Shqipëri është i tejmbushur me çmime dhe aktivitete të të njëjtës natyre. Nëse GKA ka nevojë gjithashtu të ketë çmimin e saj (dhe nëse ky çmim do quhet sërish "Onufri" apo jo) është një çështje që kërkon diskutim. Por domosdoshmëria e rikonceptimit për mua duhet të prekë edhe qëllimin dhe formën e organizimit të një çmimi (gjitmonë nëse do të ketë një të



tillë). Çmimet zakonisht jepen si shenjë njohje për krijimtarinë dhe kontributin e një artisteje/i në vite, dhe jo për një punë të shfaqur në ekspozitë - siç ishte tek "Onufri". Gjithashtu procesi i përzgjedhjes duhet të jetë i gjatë e i thelluar dhe juria duhet të jetë ndërkombëtare edhe nëse çmimi do të jetë kombëtar. Këto janë mendime të përcjella edhe nga drejtori i GKA, por për të mos larguar vëmendjen nga pyetja juaj, unë dua të ripërsëris se misioni i GKA është të realizojë shkëmbimin kulturor përmes ekspozitave të kuruara.

Aspekti i dytë problematik ka të bëjë me faktin se sot gjendemi 20 vjet pas krijimit të "Onufrit" si ekspozitë ndërkombëtare. Skena artistike shqiptare, sado e brishtë dhe e paqëndrueshme, nuk është aspak e njëjta me atë të 1998. Sot kemi një numër iniciativash të pavarura (për të cilat as që bëhej fjalë të ekzistojnë atëherë), të cilat janë dinamike dhe punojnë në nivel ndërkombëtar. Ndër to mund të përmend Qendrën Zeta, Tirana Art Lab, Miza (që tashmë është mbyllur), Art House, qendra e publikimit e nisur nga Simon Battisti dhe Leah Whitman, Bazament, Harabel, ish-Tirana Express apo Qendra Tulla, T.I.C.A. e të tjera të cilat mund të mos i kem hasur. Jo vetëm numri, por dhe niveli i veprimtarive të këtyre iniciativave është serioz dhe i pakrahueshëm me një pjesë të mirë të edicioneve të "Onufrit", të cilat ishin katandisur në një lloj formaliteti pa vizitorë, pa publik e pa asnjë program edukimi apo ndërmjetësimi. Pjesa më e madhe e këtyre iniciativave drejtohet nga artistë e kuratorë të cilët kanë kaluar nga përvoja e Onufrit. Ky është një tjetër tregues se misioni për të cilin Onufri u krijua është përmbushur tashmë dhe vazhdimi i aktivitetit në të njëjtën formë është jo vetëm pa fryt por edhe mungesë respekti ndaj kryesës vendase dhe punës që ata kryejnë.





**A ka pasur diskutime në bord për të arritur në këtë vendim?**

Absolutisht po, dhe jo pak. Për hir të së vërtetës unë e kam ngritur këtë shqetësim që në mbledhjen e parë të bordit, duke këmbëngulur në domosdoshmërinë e krijimit të formave të reja të shkëmbimit. Por duke qenë se Erzeni (Shkololli) sapo kish marrë detyrën, ju desh kohë të kuptonte kontekstin dhe problematikat që unë parashtrova. Përveç kësaj, ai erdhi në detyrë në një kohë kur GKA po ndërron statusin dhe formën e organizimit, kur ai po përpigjet të prezantojë një organigramë dhe etikë të re pune dhe marrëdhënie me stafin e GKA, etj. Kështu u deshën disa muaj që shqetësimi i ngritur në atë mbledhje të parë të bordit të merrte një formë konkrete, dhe në bashkëbisedim me të gjithë kolegët e tjerë në mbërritjen në përfundimin se është vetë koha që GKA duhet të ndërpresë punën me formatin problematik të çmim/eksponitës dhe të krijojë veprimtaritë e saj të linjës që do të mundësojnë shkëmbimin kulturor.

**Ju e dini që mbyllja e tij u synua nga Ministria e Kulturës tri vite më parë. Tri vite më pas, konkursi u mbyll por sa ka ndryshuar qasja ndaj artit bashkëkohor në vend? Vëmendja dhe financimi nga buxheti publik për artin pamor?**

E di, dhe kam qenë pro mbylljes dhe në atë kohë, me të njëjtat argumente që po ju jap dhe juve. Qasja apo vëmendja ndaj artit bashkëkohor për mendimin tim ka ndryshuar në disa nivele, por nuk ka pësuar asnjë ndryshim strukturor, gjë që është për të ardhur keq. Nga një anë kemi parë një vëmendje të madhe ndaj Bienales së Venecias, si vitrina më e madhe e artit të sotëm. Tani Shqipëria merr pjesë rregullisht në të dyja bienalet, të artit dhe arkitekturës. Madje për herë të parë në katër vitet e

“  
Qasja apo vëmendja ndaj artit bashkëkohor për mendimin tim ka ndryshuar në disa nivele, por nuk ka pësuar asnjë ndryshim strukturor, gjë që është për të ardhur keq

fundit kemi parë edhe ngritjen e një strukture të re për përzgjedhjen e përfaqësuesve përmes një jurie ndërkomëtare që shqyrton propozimet (nuk e di nëse aplikohet ende apo jo). Gjithashtu, ka një përpjekje për të mbështetur nga pak të gjithë ato iniciativa që punojnë me ngulm e vetëmohim përmes buxhetit të projekteve. Unë e kuptoj se për çdo qeveri në pushtet është një sfidë e madhe të menaxhojë e mbështesë kulturën, madje jo vetëm në Shqipëri. Por problemi për mua qëndron gjetkë, dhe unë këtë ia kam bërë me dije edhe institucioneve përkatëse. Për mua është urgjente nevoja për të ndërruar mënyrën e shpërndarjes së mbështetjes dhe jo domosdoshmërisht shumat në dispozicion. Ne kemi nevojë të dalim nga format e paqëndrueshme të mbështetjes së projekteve, çmimeve apo aktivitetëve të ngjashme, si dhe trajtimit të institucioneve të kulturës me të njëjtën kornizë ligjore si kompanitë apo entet e tjera shtetërore. Nëse ka një tipar që ka karakterizuar skenën shqiptare, ai është paqëndrueshmëria. Por kjo është e lidhur me format e financimit,

dhe e përsëris, jo thjesht me sasinë që vihet në dispozicion (kjo padyshim duhet rishikuar, gjithashtu), por me mënyrën e shpërndarjes së financimit. Institucionet dhe iniciativat duhet të dalin nga gracka e projekteve dhe e çmimeve e duhet të punojnë me vizion e programe afatgjata. Dhe mbështetja që ofrohet duhet të shkojë për strukturat e iniciativave (d.m.th. për ata që punojnë) dhe për artistët madje në formë pagese sado modeste qoftë, jo thjesht për ekspozitë, apo katalog, apo projekt. Është për të ardhur keq që forma e mbështetjes është e njëjta që nga ndërrimi i regjimeve dhe madje në rang bashkish është akoma më keq, pasi projektet marrin mbështetjen vetëm pasi të jenë realizuar - kulmi i absurdit. Vetëm kur të krijohet ndërgjegjia institucionale për të adresuar këto probleme do të mund të krijojmë vazhdimësi dhe të ndërtojmë si në rang institucionesh ashtu dhe në nivelin e skenës së pavarur. Me sa mbaj mend Ministria e Kulturës filloi një proces dialogu me skenën e pavarur të artit, por nuk e kam ndjekur më tej se ç'ndodhi më pas, a ka reflektim, përmbljedhje, ndryshime të kuadrit ligjor etj.

**Çfarë do ta zëvendësojë një aktivitet si Onufri në Tiranë?**

Kjo është detyrë e stafit dhe drejtuesit të GKA dhe besoj se së shpejti do të njoftohemi për këtë. Për mua është me rëndësi t'i jepet kohë kësaj here procesit të reflektimit që nga një anë të shmangen probleme si ato të hasura në strukturën e "Onufrit", e nga ana tjetër të krijojen struktura të bazuara mbi kërkimet kuratoriale, por që janë të hapura ndaj ndryshimit në kohë. Sepse siç e tregoi dhe përvoja e "Onufrit", strukturat e ngurta e të pandryshueshme janë të destinuara të kockëzohen e më pas të zëvendësohen.

**Çfarë keni propozuar ju për formatimin dhe qasjen e re të GKA që ajo të kthehet në një plat-**

**formë për shkëmbimin kulturor ndërkomëtar?**

Nuk është detyra ime të propozoj format konkrete sepse unë nuk punoj në GKA. Për mua është me rëndësi të diskutojmë për vizionin e institucionit, i cili mendoj se duhet të zhvillojë një punë e proces kërkimor me stafin e tij por edhe me kuratorë të jashtëm, në mënyrë që të mund të reflektojnë ndryshimet e mëdha që karakterizojnë kohën në të cilën jetojmë por edhe praktikatat e reja artistike që janë zhvilluar. Shumë artistë sot si në rajon ashtu dhe në botë punojnë me çështje të rëndësishme dhe të ndër-lidhura që trajtojnë tema të gjëra, që nga impakti dhe shkatërrimi që ne njerëzit i kemi shkaktuar planetit dhe qenieve të tjera, tek valët e emigrantëve që ikin nga lufta, thatësira apo uria, tek ngritja e populizmit, nacionalizmit dhe formave të reja të fashizmit në nivel global, apo dhe daljen e liderëve reaksionarë si Donald Trump në SHBA, Bolsonaro në Brazil e deri tek Viktor Orban dhe Erdogan në rajonin tonë. Artistët, si në Shqipëri ashtu dhe në botë, hulumtojnë e angazhohen vazhdimisht me këto realitete përmes formave të reja të shprehjes dhe për më tepër ofrojnë shkëndija realitetesh të tjera të mundshme duke i hapur udhë imagjinatës. Shkëmbimi kulturor i realizuar nga GKA duhet të reflektojë këto dinamika globale por edhe lokale, si dhe praktikatat artistike përkatëse duke bashkëpunuar dhe ftuar kuratorë aktivë, vendas dhe të huaj, që punojnë dhe artikulojnë të tilla problematika. Përkundrazi, GKA duhet të krijojë edhe mekanizmat dhe strukturat e duhura kërkimore dhe ekspozuese për të gjurmuar, mbledhur e mbajtur pulsën e skenës vendase, e cila mund të themi se tashmë shtrihet përtej kufijve fizikë të Shqipërisë. Një punë e madhe mbetet për të bërë edhe me koleksionin e saj, si për rindërtimin e kurimit e tij përmes spektrit e kontekstit historik, ashtu dhe përmes huadhenies e nxjerrjes së veprave në muze të tjerë në rajon e botë. Dhe së fundi, por jo për nga rëndësia, një theks i veçantë duhet vënë në programet e edukimit dhe ndërmjetësimit përmes të cilave të mund të krijojmë marrëdhënie aktive me publikun duke synuar gjallërimin e institucionit përmes pjesëmarrjes. Të gjitha këto janë çështje të përbashkëta diskutimi, të sjella në vëmendje dhe nga drejtuesi i institucionit. Por është e domosdoshme që tani këto përpjekje të formulohen dhe të komunikohen publikisht, të shpalosura në vizionin e institucionit, dhe me sa di unë ky është një prioritet i GKA.

**Kaq vite disi i shkëputur nga skena artistike e Shqipërisë - si i sheh Muka zhvillimet në skenat e vogla të Tiranës?**

Duke qenë se deri tani folëm për probleme dhe për t'u shmagur tundimit për të parë vetëm probleme do përpigjet të përgjigjem në lidhje me aspektet pozitive që kam vënë re. Kështu, me kënaqësi vërej se ka shumë të rinj që prej disa vitesh tani punojnë me ngulm dhe realizojnë programe të mira aktivitetesh që nuk mbeten në cakun e thjeshtë të ekspozitave. Sfidat vazhdojnë të jenë të shumta, sidomos për faktin se realiteti socio-politik shqiptar është i vrullshëm dhe i

dhunshëm. Shqipëria jonë ende lëngon në një gjendje të ndërmjetme pa arritur të ndërtojë ndërgjegjen qytetare dhe ndjesinë e kolektivitetit pozitiv, ku njerëzit të ndërgjegjësohen se kemi me shumë gjëra që na bashkojnë si komunitet sesa na ndajnë si indi-vidë. Politika dhe shoqëria vazhdojnë të dominohen nga dhuna, verbale dhe fizike, dhe modeli i vetëm i pranuar si mishërimi i suksesit është njëshi, i forti, mashkulli. Për këto arsye dhe shumë të tjera, nuk është e lehtë që këto situata të mund t'i artikulojë estetikisht. Për më tepër, ky fragmentizim i shoqërisë pasqyrohet dhe në skenën artistike, e cila gjithashtu është e polarizuar, e ndikuar politikisht dhe për më tepër mosbesuese në raport me institucionet. Megjithatë, paçka se në formë të paqëndrueshme dhe në shkallë të vogël, në skenën shqiptare gjen pothuajse të gjithat tiparet e zhvillimit që has në skenë të tjera në botë. Ajo ç'ka është interesante kohët e fundit, është lindja dhe zhvillimi i iniciativave idealiste - me fjalë të tjera, që nuk kanë ambicien të shndërrohen në evente spektakolare apo super institucione, por të krijojnë një ndjesi komuniteti artistik e t'i shërbejnë atij me përkushtim. E tillë është për shembull përpjekja e Adrian Pacit, i cili hapi shtëpinë e tij për komunitetin e qytetit të Shkodrës e dalëngadalë po zhvillon programe me tepër vlerë për artistët e rinj, pa u formalizuar si një qendër arti apo galeri por duke mbetur siç u nis, një shtëpi arti. Po ashtu, një funksion të rëndësishëm po luan dhe iniciativa e Simon Batistit dhe Leah Whitman në Tiranë, që për herë të parë po plotësojnë vakumin teorik që ka ekzistuar historikisht në Shqipëri, duke sjellë këndvështrim të reja analitike. E kështu me radhë edhe shumë iniciativa të tjera që i përmenda më lart. Natyrisht që është e vështirë, dhe, siç e vura në dukje, kërkohet një vëmendje shumë më e madhe institucionale dhe ndërrim i kuadrit ligjor, sidomos ndaj këtyre nis-mave që nuk janë bienale, ekspozita apo çmime, por punë e mirëfilltë me komunitetin, jo-spektakolare, por ndërtuese. Por ajo që ka rëndësi jetike është të mos humbet pasioni, i cili në kushtet e paqëndrueshmërisë së mbështetjes institucionale mbetet motori i vetëm që mund të mbajë gjallë përpjekjet për të vazhduar. Natyrisht unë jam i ndërgjegjshëm që sot flas nga një pozicion jashtë atij realiteti. Por unë përpigjet gjithë kohën të mbaj kontaktet dhe të kontribuoj si dhe kur mundem, sidomos me mbështetje për artistët e rinj. Gjithashtu, nuk mund të harroj se pjesa më e madhe e punës time është zhvilluar në Shqipëri, në kushte të njëjta në mos më të vështira, dhe e vetmja gjë që bëri të mundur vazhdimësinë ishte pasioni. Një shprehje angleze thotë se "ku ka vullnet gjendet dhe mënyra për ta vënë në jetë atë". Ajo që i ka munguar skenës dhe që po fillon të ravijëzo-het në përpjekjet e lartpërmendura është ndjesia e intimitetit dhe qashtërisë, dy elementë kyç në formimin e komuniteteve. Dhe nëse këto zhvillime do të vazhdojnë dhe do të konsolidohen, nuk do të duhet shumë kohë deri kur të shohim konture më të qarta të komunitetit artistik, të paktën në artet pamore.

Moti i keq dhe temperaturat e ulëta kanë përfshirë mbarë vendin. Mbrëmjen e djeshme, trashësia e borës në Tepele në arri në 30 centimetër, ndërsa në Kurvelesh rruga ishte e kalueshme vetëm me zinxhirë. Moti i keq gjithashtu ka bllokuar edhe Memaliajn, ndërkohë u zhbllokua rruga në njësinë Buzë, e cila ishte e bllokuar pas reshjeve të borës. Në Frashër të Përmetit gjendja është përmirësuar dhe makinat lëvizin vetëm me zinxhirë. Në Zagorje të Libohovës situata paraqitet më pak problematike dhe kalimet e mjeveve kryhen duke përdorur zinxhirët. Ndërkaq po në Gjirokastrë nga reshjet e dëborës u bllokua aksii Taroninë-Fushë-Bardhë si dhe segmenti Rehovë-Golem. Autoriteti Rrugor Shqiptar njoftoi se sasia e reshjeve të

## "Janë marrë masat për mbarëvajtjen e situatës"

# Bora "pushton" Shqipërinë, ARRSH: Akset ku duhet të lëvizni me zinxhirë

### SITUATA

Në Zagorje të Libohovës situata paraqitet më pak problematike dhe kalimet e mjeveve kryhen duke përdorur zinxhirët. Ndërkaq po në Gjirokastrë nga reshjet e dëborës u bllokua aksii Taroninë-Fushë-Bardhë si dhe segmenti Rehovë-Golem. Autoriteti Rrugor Shqiptar njoftoi se sasia e reshjeve të

borës në Llogorja është intensive, e në punë janë 3 borëpastruese dhe 1 fadromë. Po kështu ARRSH thotë se drejtuesit e mjeveve që duhet ta përkohjnë këtë rrugë duhet t'i kenë vendosur me patjetër gomat e dimrit dhe zinxhirët në të kundër kalimi është i pamundur dhe nuk do të le-

johet lëvizja mjeveve pa zinxhirë dhe goma dimri. Sipas ARRSH në të gjitha akset kryesore të vendit që ka pasur reshje bora janë marrë të gjitha masat e nevojshme nga kontraktorët dhe kompanitë e mirëmbajtjes. Është bërë trajtimi me kripë dhe pastrimi i rrugës nga

bora. "Në Dardhë, Voskopojë, Bigëll Gorricë dhe në Qafën e Qarrit, rekomandohet përdorimi i zinxhirëve, për shkak të prezencës së ngricave në rrugë, pasi temperaturat janë shumë të ulëta. Në Qafë Thanë - Kapshticë ka pasur reshje të dobëta. Është bërë pastrimi dhe qarkullimi kry-



het pa zinxhirë. Në segmentin fundor prej 20 km të aksit Ura e Cerenecit - Steblevë rekomandohet përdorimi i zinxhirëve, për shkak të ngricave në rrugë. Në segmentin Lunik-Steblevë rekomandohet përdorimi i zinxhirëve për shkak të pranisë së ngricave në rrugë. Kontraktorët

po punojnë në të gjitha akset për pastrimin dhe shpërndarjen e kripës. Rekomandohet përdoruesit e rrugës të bëjnë kujdes gjatë lëvizjes në akset ku ka prezencë ngricash dhe të respektojnë sinjalistikën rrugore", thekson Autoriteti Rrugor Shqiptar.

"Segmenti mbikalimi Kamzë - mbikalimi Qafë Kashar, Rinas do të mbyllet plotësisht"

# Fillojnë punimet në autostradën Tiranë-Durrës, ja si do të devijohet qarkullimi

Autoriteti Rrugor Shqiptar: Si do të lëvizin automjetet për dy javë

Ditën e djeshme kanë nisur punimet në autostradën Tiranë-Durrës, çka ka sjellë edhe devijimin e trafikut për të gjitha automjetet për 15 ditë. Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Policia e Qarkullimit Rrugor kanë bërë me dije planin e përditësuar të devijimit të trafikut në këtë aks me qëllim shmangien e bllokimit të qarkullimit të mjeveve. Sipas ARRSH, trafiku do të devijohet për të gjitha mjetet në rrugën dytësore, të cilat do të funksionojnë me një drejtim lëvizje. Punimet do të zgjasin për dy javë. "Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Policia e Qarkullimit Rrugor informojnë median dhe opinionin publik se në vijim të njoftimit të mëparshëm, lidhur me ndërtimin e dy tobinove në segmentin rrugor (autostrada) Tiranë-Qafë Kashar (kthesa Rinas) në kilometrin 6+600 dhe 6+800 (Kastrati) & Alba-Elletrica, plani i përditësuar i devijimit të trafikut me sinjalistikën e duhur të përkohshme për të shmangur bllokimin e qarkullimit dhe garantuar mbarëvajtjen e punës në terren do të jetë si më poshtë: autostrada Tiranë - Durrës në segmentin Mbikalimin Kamzë-Mbikalimi Qafë Kashar, Rinas do të mbyllet plotësisht për trafikun në të dyja drejtimet e lëvizjes", thekson ARRSH. Kjo e fundit bën me dije se trafiku do të devijohet për të gjitha mjetet në rrugën dytësore, të cilat do të funksionojnë me një drejtim lëvizje, ndërsa dalja në rrugët dytësore është e mundur te Spitali Hygeia, QUT si dhe te kthesa e Domjes (ku është krijuar një rrugë aksesi e përkohshme). "Rekomandojmë përdoruesit e rrugës që gjatë kësaj kohe të zgjedhin rrugë alter-



Autostrada Tiranë-Durrës

### DEVIJIMI I AUTOMJETEVE

1. Autostrada Tiranë - Durrës në segmentin mbikalimin Kamzë - mbikalimi Qafë Kashar, Rinas do të mbyllet plotësisht për trafikun në të dyja drejtimet e lëvizjes.
2. Trafiku do të devijohet për të gjitha mjetet në rrugën dytësore të cilat do të funksionojnë me një drejtim lëvizje.
3. Dalja në rrugët dytësore është e mundur te Spitali Hygeia, QUT si dhe te kthesa e Domjes (ku është krijuar një rrugë aksesi e përkohshme).
4. Rekomandojmë përdoruesit e rrugës që gjatë kësaj kohe të zgjedhin rrugë alternative për lëvizjet në drejtim të veriut (nga Kamza) dhe drejtim të Jugut (nga Ndroqi ose Elbasani).

native për lëvizjet në drejtim të veriut (nga Kamza) dhe drejtim të Jugut (nga Ndroqi ose Elbasani). ARRSH dhe Policia e Qarkullimit Rrugor kërkojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e drejtuesve të mjeveve dhe bizneseve të zonës gjatë procesit të ndërhyrjes në këtë aks rrugor dhe respektimin në mënyrë rigorozë sinjalistikën provizore të vendosur dhe udhëzimet e policisë rrugore në terren", bën me dije Autoriteti Rrugor Shqiptar. Nga ana e këtij të fundit dhe Policisë së Qarkullimit Rrugor është hartuar një plan operacional i ndërhyrjes dhe devijimit të trafikut për të shmangur bllokimin e qarkullimit dhe për të garantuar mbarëvajtjen e punës në terren.

### FUSHË-KRUJË

Një aksidenti automobilistik ka ndodhur mesditën e djeshme në Fushë-Krujë. Sipas të dhënave paraprake, aksidenti u shënuar në Qafështamë ku një makinë ka dalë nga rruga dhe ka rënë në humnerë. Fatmirësisht nga aksidenti nuk raportohen për persona të lënduar. Policia është nisur menjëherë drejt vendngjarjes dhe ka nisur hetimet. Ndërkohë, ende nuk rethanan e këtij aksidenti.

### SHKURTE

## Tërmeti "shkund" Jugun e Shqipërisë, dëmtohen kater banesa

Një tërmet me magnitudë 4.8 ballë ka rënë mbrëmë në jug të vendit. Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, bëri me dije se në orën 20:26 është regjistruar një lëkundje tërmeti me magnitudë 4.8 rihet me koordinatë 40.05 Veri dhe 19.88 Lindje me thellësi 27 km me epigendër në Borsh. Nga të dhënat paraprake nuk ka njerëz të lënduar, por vetëm dëme materiale në 5 banesa, në fshatin Kuç. Mësohet se 4 prej banesave kanë dëmtime të lehta dhe 1 është dëmtuar me rëndë. Tërmeti është shoqëruar me një pasqorditje me magnitudë 4 rihet me koordinatë 39.95 veri dhe 19.7 lindje me thellësi 33 km dhe epigendër në detin Jon.

## Makina del nga rruga humb jetën 35-vjeçarja

Leonarda Boro ka humbur dje jetën në një aksident të ndodhur në Sarandë, ndërsa janë plagosur dy persona të tjerë. Ngjarja ndodhi rreth orës 09:20, në afërsi të liqenit në fshatin Mursi. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se automjeti "Benz-2500" me drejtues shtetasin O.M., 21 vjeç, ka dalë nga rruga dhe ka goditur 3 këmbësorë. Si pasojë e goditjes vdiq në vend 35-vjeçarja, ndërsa u plagosën Saimir Stola, 33 vjeç dhe Gentian Stogani, 38 vjeç. Menjëherë policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e shkaqeve të këtij aksidenti.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 642

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 5 Janar 2019

## VILDANE ZENELI U PUTH NË BUZË ME TUNËN?



**"Ja si qëndron e vërteta e skenës"**

## FJOLLA MORINA

tërbon fansat, provokon e veshur  
me fustan ku i shpërthen gjoksi



**RIKTHEHET**

## MARINA VJOLLCA?





Detaji që zgjon dyshimet. Me  
pushime në Las Vegas, motra  
e saj shfaq lajmin e papritur



## KONFIRMIMI

**NA THYEN ZEMRAT! JA E  
VËRTETA E LIDHJES MËS  
FEROS DHE ARBENITËS**





Me pushime në Las Vegas, motra e saj shfaq lajmin e papritur

# Rikthehet Marina Vjollca? Ja detaji që zgjon dyshimet

*E larguar prej një viti nga ekrani,  
moderatorja zbulon se kur do të rikthehet*



Pamela Aliaj

U bë më shumë se një vit që moderatorja e njohur Marina Vjollca nuk është në ekran. Në fillimin televiziv, në shtator Marina Vjollca ishte moderatorja më e komentuar që, sipas gjasave, mbeti pa një program të ri në ekran. Pas "C'est la vie", programi i parë që iu besua Marinës në Tv Klan, moderatorja është përfolur për disa projekte që pritet të nisin. Por deri tani nuk kemi parë asgjë konkret nga bukuoshja e njohur. Para disa kohësh Marina lajmëroi se do të vinte shumë shpejt në ekran. Këtë gjë na e zbuloi gazetari, Eraldo Rexho. Ai e ka pyetur moderatoren se kur do ta shohim në ekran: "Shumë shpejt...", - thotë ajo pa dashur të zbulojë më shumë. Siç është mësuar më


herët Marina pritet të drejtojë një program të ri që në fokus do të ketë fëmijët. Por më vonë u duk se ky plan u hodh poshtë për shkak se bashkëshorti i saj, Getoar nuk u kënaq me kushtet që i ofruan pjesëtarët e Klan, duke qenë se edhe ai ishte pjesë e jurisë së emisionit, dhe si përfundim anuloi emisionin me mospranimin e vajtjes së të dyve. U fol e u përfol shumë për Getoarin dhe Marinën, por së fundi Luana Vjollca i mbylli të gjitha gojë të liga. Në nisjen e sezonit të ri televiziv një nga moderatorët që mbeti pa emision ishte Marina Vjollca. Nëpër media u përfol se shkak ishte bashkëshorti i saj, Getoar Selimi, i cili kontrollonte çdo gjë të moderatorës. Marina Vjollca ka qenë shumë e kome-

tuar gjatë vitit që lamë pas për faktin se në cilin emision do e shihnim sërish. Por pas përfundimit të "C'est la vie" në janar, Marina u zhduk nga ekrani dhe preferoi t'i jepte pak më hapësirë jetës private me udhëtime të shumta. Mirëpo këtë vit Marina do rikthehet në ekran me një emision të ri e këtë e ka zbuluar Luana. Në postimin e fundit të Luanës, Marina i shkruan se ndihet krenare për suksesin që ka arritur. Ndërsa Luana ja kthen: "Mezi po pres për bombë tënde tani, jetë", duke lënë të kuptohet se jo vetëm që do ta shohim në ekran, por që do jetë super. Ndërkaq në një foto të fundit të postuar ajo shfaqet e veshur me të zeza dhe pas ka pamjen e një salle të madhe shfaqesh. Në mbishkrim të fotos ajo shkruan: Koha për shfaqje. Kaq mjaftoi që ndjekësit e saj të mendojnë se ajo u kthye edhe pse ishte veçse një foto e vendit në të cilin ajo me Getoarin kishin shkruar për të parë një shfaqje në Las Vegas, ku kanë shkruar me pushime. Por kur do ta shohim moderatorën vërtetë nën drejtimin e një show dhe jo si spektatore? Nga komentet e bëra së fundi mes motrash duket se nuk do të vonojë një shfaqje e tillë. Me shumë gjasa do të presim paraqitjen çift të tyre në atë që po rrezervojnë.



## Ç'të përmbajë disku? Enca hedh në det 'kujtimet e vjetra'!

Për pushime, në ditët e para të vitit 2019, këngëtarja Enca Haxhia është relaksuar në qytetet e ndryshme të Shqipërisë së bashku me familjen e saj. Por së fundmi ajo ka publikuar një story në 'Instagram' ku shprehet se do të heqë qafe të gjitha kujtimet e vjetra. Ajo ka treguar një disk memorie, të cilin ishte gati për ta hedhur në det. Nuk dihet se çfarë përmban ai disk, por mesa duket Enca i ka hedhur mënjane të gjithë kujtimet jo të bukura dhe të vjetra. Të ketë lidhje me Noizin ky hardisk me kujtime?




## Shfajësohet më në fund! Arbana uron Xhemin për ditëlindje dhe asnjërit nuk ia priste mendja!

Arbana Osmani për shkak të ditëlindjes së shoqes së saj të ngushtë nisi ditën e enjte me një maratonë fotosh pak të "sikletshme". Por këtë herë Arbana na ka surprizuar sërish pasi për të uruar Xhemil Shehun ka publikuar një foto të saj jo në kushtet më të mira, e shfaqur me një maskë në fytyrë. Nuk dihet cili ka qenë reagimi i Xhemit pas këtij postimi, por me siguri në këtë mënyrë Arbana u shfajësua për të gjitha rastet kur Xhemil s'kishte dalë mirë në fotot e postuara prej moderatores.

## Fjolla Morina tërbon fansat, provokon e veshur me fustan ku i shpërthen gjoksi

Një ndër elementet që tërheq më tepër vëmendje si çdo vit janë asetet e bujshme trupore. Këngëtarja, Fjolla Morina përveç karrierës muzikore më së shumti në media përfillet edhe për format trupore bombastike. E tillë po vazhdon të jetë edhe në Vitin e Ri, e cila ka hedhur një fotografi në 'Instagram' në të cilën e nxjerr komplet gjoksin. "2019", është përshkrimi që ia ka vënë imazhit. Pra, do të shohim për këtë vit të ri një Fjolla bombastike dhe tepër provokuese si dhe vitet e shkuara.



## Samanta Karavella publikon klipin e ri në një ditë të veçantë e arsyeja është prekëse

Së fundmi këngëtarja Samanta Karavella ka sparalajmëruar publikimin e këngës së saj më të re. Klipi i ri titullohet 'Vonë' dhe është një bashkëpunim i saj me Elinel. Edhe këtë herë Samanta shfaqet në formë të shkëlqyer mes dëborës dhe bardhësisë që mundëson dimri. Por kjo këngë nuk është publikuar e plotë ditën e djeshme. Këngëtarja e njohur ka shpjeguar me anë të një postimi në 'Instagram' se të premten ishte ditëlindja e nipit të saj dhe kjo ishte arsyeja e publikimit. "Gëzuar Ditëlindjen Ethan. Vendosa ta publikoj këtë këngë në ditën e lindjes tënde se ti ishe i pari që e këndove me zërin tënd engjëllor! Faleminderit që na e zbukuron çdo ditë. Teja të do pafund", -shkruan ajo krahas videos së nipit, i cili këndon pak nga kënga e re. Sa e ëmbël!





Rrëfëhet modelja ndërkombëtare: Së shpejti do të lançoj një këngë

# U puth në buzë me Tunën?

## VILDANE ZENELI:

### Ja si qëndron e vërteta e skenës

Pamela Aliaj

Ajo është një nga modellet ndërkombëtare më të rëheqëse, e cila ka bërë bujë në shumë fotoshoot-ing nga firma të njohura në mbarë botën. Vildane Zeneli, bukuroshja me origjinë Kosovare, është rishfaqur sërisht këtë herë në një klip muzikor me Tunën dhe Seven Saraçin. Në videoklip u përthol së tepërmi për 'puthjen' e famshme të dhënë mes dy vajzave. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", modelja shpreh gjithë prapaskenat dhe të vërtetën e klipit. Gjithashtu, Vildane na rrëfen edhe për pasionin e saj të vegjëlisë që është muzika. Së shpejti ajo do të vijë me disa projekte në fushën e muzikës. Këto e të tjera të reja mjaft interesante në intervistën e parë të këtij viti.

**Si fillim ju uroj një vit të mbarë për 2019! Si e kaluat natën e ndërrimit të viteve?**

Faleminderit! Edhe unë ju uroj një vit të mbarë e me shumë dashuri, e me të gjitha gjërat që dëshironi në jetë! Këtë vit vendosa të festoja vitin e ri me familjen time në New York. Ka vite që gjithmonë e ka pritur me ndonjë ishull të bukur por këtë herë doja të isha me familjen dhe ata ishin shumë të lumtur që unë isha me ta të festoja. Duhet të them se ishte viti i ri më i mirë deri



*"Jam në një marrëdhënie me veten time dhe më pëlqen kështu"*

më tani! Më kujtoi kohët kur isha e vogël dhe gjithmonë festonim bashkë.

**Si ishte për ju viti 2018? Cilat ishin arritjet më të mëdha tuajat?**

Viti 2018 ka qenë një vit mjaft i mirë për mua. Kam bërë një pauzë për një kohë e cila në fakt ka zgjatur 2 vite. Kam thyer dorën shumë keq në një hotel gjatë punës dhe brenda një viti kam bërë 3 operacione. Ishte shumë e dhimbshme dhe e vështirë të përballesha, por jam me fat që kam dorën në rregull dhe mund të punoj siç duhet. E denoncova hotelin dhe u desh deri këtë verë të zgjidhej

çështja. Edhe pse nuk kam mundur të punoj si modele, jam marrë me projekte të tjera. Arritja ime më e madhe në 2018 ishte të rikthehesha në formë me trupin tim, sepse kisha marrë disa kile kur kisha për të bërë ndërhyrjet kirurgjikale dhe s'kisha mundësi të stërvitesha në palestër. Më vonë shkova në Kosovë dhe në Shqipëri për 1 muaj ku bëra disa projekte e njëkohësisht edhe u kënaqa me shoqërinë dhe familjen që kam atje. Asnjëherë më parë nuk kam ndenjur atje më shumë se kaq.

**Cilat janë 3 premtimet që i ka bërë Vildane vetes për vitin e ri?**

Zakonisht nuk jam një njeri







që bëj premtime për vitin e ri. Kam shumë gjëra në mendje dhe gjëra që dua të bëj por nuk e stresoj veten shumë, shkoj me rrymën. Çdo ditë ne na jepet mundësia për një fillim të ri dhe të fillojmë diçka të re.

**Para disa kohësh thatë që ishit duke u marrë me projektin tuaj më të ri të muzikës? Kur keni në plan për ta lançuar në treg?**

Jam marr me muzikë, por jo aq sa duhet. Kam punuar me Seven Saraçin në disa këngë, por unë jam kritikja më e keqe e vetes dhe përfundoj të mos lançoj asgjë, sepse kërkoj gjithnjë perfeksionin. E di që nuk është një gjë e mirë, por unë nuk dua thjesht të nxjerr diçka në treg vetëm, sepse duhet të lançohej një këngë.

**Për çfarë bëhet konkretisht fjalë për këngën dhe si erdhi ideja e bashkëpunimit?**

Me Seven Saraçin përveç se po punojmë në disa projekte në anglisht, kemi bërë edhe diçka në shqip. Nuk e di kur do t'i lançojmë, por ato janë këngë të lezetshme dhe argëtuese.

**Me çfarë projektesh të tjera është duke u marrë Vildane përveç këngës së parë tuajën?**

Unë jam pronare e një biznesi në pasuritë e paluajtshme ku ne blejmë shtëpi dhe i rirregullojmë ato e më pas i shesim. Është vërtet shumë argëtuese! Kam në plan të hap dhe një restorant me disa miq të mi nga India në New York që do të ketë edhe ushqim shqiptar.

**Si lindi pasioni për muzikën? Keni në plan për të vazhduar në botën e muzikës?**

Gjithmonë kam pasur pasion muzikën që kur isha një fëmijë, por të jem e singertë, nuk e di ç'dua të bëj. Më pëlqen të shkruaj, të menaxhoj të bëhem një AnR, më pëlqen gjithçka rreth muzikës. Në një mënyrë apo në një tjetër unë do të përfshihem në industrinë e muzikës.

**Ju jeni një ndër modelet që ka spikatur në botën e modës. Cili është projekti më i fundit me të cilin jeni duke u marrë?**

Deri këtë verë nuk kam mundur të punoj sepse kam



përfunduar procesin gjyqësor timin. Kam filluar me punë në gusht, mbasi përfundova vendimin e gjyqit. Projekti më i fundit që kam bërë është një fushatë për bikini për Aqua Benetta që është realizuar në Marbella të Spanjës. Gjithash-tu, kam bërë edhe një reklamë

për Super Bowl për Chrysler që sapo e kemi përfunduar. Ka edhe disa të tjera, por këto dy janë më të fundit.

**Cili ka qenë propozimi më joshës i 2018 që keni marrë dhe që nuk ua priste mendja? Si keni reaguar?**

Unë marrë shumë propo-



zime shpeshherë dhe është e vështirë t'i mbaj mend ose edhe të argëtohem me to, sepse vërtetë janë shumë.

**Para pak kohësh u shfaqët në një videoklip së bashku me Tunën. Si erdhi propozimi për të qenë pjesë e këngës?**

Po për shkak se kam Seven Saraçin shok të ngushtë dhe se kisha për të shkruar në Kosovë në atë kohë, pasi ma tregoi këngën më pëlqeu shumë. Edhe ai po e mendonte se kështu do të merrte në video e më tha: Vildane, ti do të ishe perfekte për këtë video. Duke qenë se unë e kam shumë xhan dhe ai është si një vëlla për mua, unë i thashë që sigurisht që do ta bëja një gjë të tillë për të. Në fakt, unë as që nuk e njihja Tunën. Normal që e dija kush ishte por nuk e kisha takuar ndonjëherë deri ditën para xhirimeve. Ne u kënaqëm shumë kur po bënim xhirimet e videos. Ajo ishte shumë simpatike dhe sigurisht që unë do bëja gjithçka për Sevenin, sepse këtë bëjnë shokët e vërtetë, ata mbështesin njëri-tjetrin.

**U përfolët se ishit puthur në buzë me Tunën, a është e vërtetë?**

Jo, nuk është e vërtetë që jemi puthur, asnjëherë. I gjithë xhirimi ishte shumë argëtues dhe autentik. Gjithçka ka qenë argëtuese, e qetë dhe në bëmë atë që e ndjemë të drejtë. Normal që të dy kanë qenë të dashuruar me të njëjtën vajzë dhe ziheshin për ndjenjat e saj, në këtë rast Maria që isha unë, por ishte shumë klasike e aspak vulgare. E di që njerëzit duan të besojnë se ne u puthëm, por nuk ndodhi ashtu. Ne duhet të

bënim që të besohej se kishte pasion dhe duhet të kishte kimi. Tuna ishte vërtet e shkëlqyer dhe unë kalova momente fantastike duke luajtur si e dashura e saj, siç bëra me Sevenin. Ishte thjesht seksi e klasike e asgjë e çmendur.

**Vildane më mirë një karrierë si modele, këngëtare apo...? Ku e gjeni veten më mirë?**

Të dyja janë mirë. Po mos të ishin të mira të dyja nuk do i kisha bërë. Por më shumë kam eksperiencë dhe karrierë si modele. Dhe si modele unë kam arritur shumë, por muzika është diçka që unë e dua, edhe nëse bëhem e suksesshme apo jo, nuk ka rëndësi. Thjesht më pëlqen ta bëj.

**Nëpër rrjete sociale nuk keni postuar foto nga jeta juaj private. A është dikush në jetën tuaj?**

Kjo është arsyeja pse është quajtur jeta private, sepse është e destinuar të jetë e tillë. Ditët e sotme gjithçka shfaqet në rrjetet sociale dhe ja pse gjërat bëhen lësh. Unë besoj që nëse të duhet të shfaqësh se sa e dashuruar je dhe se sa e lumtur ti je, atëherë ti nuk je në të vërtetë e lumtur, sepse nuk e di pse ti duhet të provosh diçka tek dikush, sidomos diçka personale dhe special për ty. Unë nuk jam një nga ata persona që më pëlqen të postoj foto e të mburrem dhe të flas lidhur me diçka që ka shumë rëndësi për mua dhe vetëm mua. Edhe pse unë jam për momentin single dhe shumë e lumtur. Jam në një marrëdhënie me veten time dhe më pëlqen kështu.

**Cili është pasioni i fshehtë i Vildanes? Nëse nuk do të merreshit me modeling dhe muzikë, çfarë do të zgjidhnit të bënit në jetë?**

Unë kam mbaruar shkollën për Menaxhim e biznes International në NYU Stern që është ndër kolegjet më të mira në SHBA. D.m.th. kam një plan rezervë. Nëse dua të punoj në fushën e biznesit, është shumë e thjeshtë. Një gjë tjetër që do të doja të isha është një dentiste apo një investigatore private sepse më tërheq shumë të zgjidh çështje të krimit. Është e frikshme por interesante.



## Pas moderimit në një plan të ri? Ja ç'i shkrepri në kokë Alketa Vejsiut kur ishte me pushime

Alketa Vejsiu ka vendosur ta nisë vitin e ri me disa ditë pushimi pranë njerëzve më të dashur. Edhe pse me pushime, mes Alpeve, në mes të dëborës dhe rehatisë, Alketa ka publikuar shpesh imazhe nga pushimet. Së fundmi ajo ndau me ndjekësit një video të shkurtër, në sfond të së cilës dëgjohet një këngë italiane. Përveç asaj që përcjell video në sy ra edhe shkrimi që moderatorja e njohur i kishte bashkangjitur. "Doja të qëndroja pak vetëm që të mendoja... Kaq shumë gjëra të bukura. Një ditë do bëj një film", -e përfundon shkrimin ajo. Pra, ja dhe projekti më i ri moderatorës. Të jetë frymëzues si çdo gjë tjetër që ajo bën? Të shohim ç'rezervon moderatorja!




## Kënga e Eneda Tarifës dedikim për bashkëshortin? "Jam lodhur nga..."

Pas pushimeve, Eneda Tarifa ka qenë e ftuara në emisionin "Trokit" në InTV ku ndër të tjera ka folur edhe për këngën e saj më të fundit "Nuk ja vlen". Kënga, menjëherë pas publikimit, u perceptua dhe komentua në publik si një dedikim për ish-bashkëshortin e këngëtares, muzikantin Erion Zaloshnja, por që Eneda i ka mohuar këto zëra. "Këngën e ka shkruar Fifi. Unë tani jam e penalizuar të bëj këngë të ndjerë, e do bëjnë lidhjet portalet. Këngët nuk janë gjithmonë personale", -ka thënë artistja. Ajo pranoi se në fillim nuk e dinte se kënga do të komentohej në këtë aspekt, dhe se thjesht e pëlqeu kur e dëgjo. Jo vetëm kaq, por duket se Eneda madje është lodhur nga gjithë lajmet e rreme që kanë qarkulluar për të e madje ka komplimentuar dhe vlerësuar ligjin antishpifje që kryeministri Rama duhet ta bëjë menjëherë. Pra, jo më prapaskena për gjëra të paqena, apo jo?

## Qenka në gjak! Jo vetëm Loredana, por dhe motra e lidhur me reper të njohur

Pa filluar mirë viti zbuluam një tjetër çift të ri tek vip-at tanë. Kësaj radhe bëhet fjalë për një lidhje mes këngëtarit Gent Fatali dhe motrës së Loredanës. Rozafa, motra e këngëtares Loredana duket të jetë në një lidhje me Gentin. Ata janë munduar ta mbajnë të fshehtë këtë lidhje, mirëpo nga komentet e shumta në profilet e njëri-tjetrit në 'Instagram', ka qenë e "pamundur" të mos dyshohet për një lidhje mes tyre. Gjithsesi, një foto nga Gent Fatali ku shfaqet me Rozafën edhe pse ajo e ka mbuluar fytyrën, i ka shuar dyshimet e lidhjes. Rozafa po ta shikoni nga fotot që publikon në 'Instagram' duket se ka krijuar një profil bloggeree dhe ka një ngjashmëri të madhe me Loredanën. Është në gjak, s'ka si të jetë ndryshe!



## Flori Mumajesi i propozon martesë, por reagimi i Bebe Rexhës nuk pritej

Ja që ka femra si Bebe Rexha që mesazhin e këngëtarit të njohur Flori Mumajesi, ia lë pa përgjigje! Pas një statusi të Bebe Rexhës, ku ajo i ka kërkuar 'burrit të saj të ardhshëm' që të shkojë tek ajo sa më shpejt, këngëtarin nga Shqipëria, Flori Mumajesi nuk ka vonuar për t'i shkruar. Flori, i cili këngëtares me famë botërore e ka shumë xhan, i ka 'trokitur' në derë duke i thënë se ai është 'burri i saj'. Derisa të gjithë, madje edhe Flori, e prisnin reagimin e Bebes, ajo duket se vetëm e ka lexuar propozimin e Florit dhe ia ka lënë 'Seen'. Flori këtë e ka ndarë me fansat, duke treguar se, megjithëse ka marrë vetëm 'seen', ai s'ërisht e ka shumë xhan Beben. Epo ka dhe kështu!



## “Cilët janë njerëzit që janë vrarë për ty?” Adelina Ismaili befason me përgjigjen ndaj akuzës

Ajo është padyshim diva e muzikës shqiptare, e cila për vite me radhë ka kontribuar me muzikën e saj në vendin tonë. Adelina Ismaili ka sjellë me muzikën e saj më pranë njerëzve dhe situatën e rënduar politike në vitet kur Kosova ishte në luftë duke u bërë një heroinë në mënyrën e saj për atdheun. Të gjithë e mbajnë mend këngën e famshme të Adelinës “Ushtrinë time do ta bëj me Ibrahim Rugovën” të cilën e kujtuam në ditën e krijimit të Ushtrisë së Kosovës në datën 14 dhjetor 2018. Vetë Adelina u shprehet e emocionuar për krijimin e kësaj ushtrie të cilës ajo i kishte kënduar shumë vite më parë dhe intervista e saj për “Klan Kosova” lidhur me këtë ngjarje madhore ka rezultuar mjaft e klikuar dhe këngëtarja e ka zbuluar përmes një postimi në ‘Instagram’.

“Ka kaq shumë reagime për pikëpamjet e mia politike! Mos vallë duhet të kandidoj për Presidente?”

— ka shkruar Adelina në postimin e saj duke na lënë të dyshojmë se mbase shumë shpejt do ta shohim duke drejtuar Kosovën. Mirëpo edhe pse komentet pozitive janë të shumta, ka dhe komente negative të cilave Adelina nuk përtan t’u përgjigjet. “Na mbyte me këto fjalime e mendime të mykëta. Adelina ti mundesh me tregu për ndonjë gjë që ke bërë për njerëzit që janë vrarë për ty se nëse mbetesh me na tregu ti se kush e ka bërë ushtrinë neve na ...

.” Pas këtij komentit akuzues dhe aspak dashamirës këngëtarja ka përcjellë një mesazh paqësor për komentuesen duke shkruar: “Mos e ndiq çdo hap timin se mund të nervozohesh kot. Nëse di diçka për vrasjet e mia, unë personalisht do ta shkruaj ty emrin si dëshmitare të dëshmosh në polici dhe gjykatë. Por mos ofendo është nivel shumë i ulët. Page” !

nita.velyu13 Na myte bre me kto fjalime e me kto mendime tmykta, Adelina ti mundesh me na kallu për naj magjuplak tanin që e ke ba deri tash e për njerz që jon vra për ty se nkoft me me na kallu ti kush e ka ba ushtrin nav ka q\* nana.

adelinaofficial @nita.velyu13 Nuk ke nevojë me përcjell çdo hap timin, mundesh mu nervozu kot. Nese din diçka për vrasjet e mia, unë personalisht do ta shkruaj ty emrin dëshmitare të dëshmosh në polici dhe gjykatë. Por, mos ofendo, është nivel shumë i ulte. Peace 🙏



## Na thyen zemrat! Ja e vërteta e lidhjes mes Feros dhe Arbenitës

Së fundmi ka bërë shumë bujë në mediat rozë lajmi se mes reperit Fero dhe modeles së njohur Arbenita Ismajli ka një lidhje mes tyre. Shkak u bënë fotot ku dyshja shfaqeshin në të njëjtat vende dhe komentet mes tyre tepër intime. Si Fero, edhe Arbenita nuk i kursenin fjalët e ëmbla ndaj njëri-tjetrit, dhe kjo bëri që lajmet mbi lidhjen e tyre të shtoheshin edhe më shumë. Mirëpo e vërteta është që Fero nuk është në një lidhje me Arbenitën, pasi me të ka një marrëdhënie tjetër, atë të miqësisë, te paktën sipas tij. I pyetur në “Sevenbizz”, nëse është i lidhur apo jo me Arbenitën, Fero u përgjigj: “E kam shoqe shumë të mirë, shoqe të ngushtë dhe asgjë më shumë”. Të jetë e vërtetë apo reperi ka dashur të heqë vëmendjen nga të dy?



## Largohet në SHBA, bloggerja e njohur shqiptare paska luftuar me tumorin

Vetëm pak kohë më parë, bloggerja e njohur shqiptare, Estela Ujka, njoftoi se do të shpërngulej për të jetuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkë me familjen e saj, bashkëshortin dhe 3 vajzat. Fillimisht ajo vizitoi e vetme New York-un ku edhe lindi vajzën e saj Damar Brooklyn. Më pas Estela Ujka u shpërngul përfundimisht në SHBA me familjen, ku hapi edhe një biznes të sajën. Por e ardhmja e saj dhe e familjes duket se nuk kanë qenë arsyeja e vetme përse Estela shkoi në SHBA. Bloggerja ka treguar përmes një postimi në ‘Instagram’ se ka bërë një ndërhyrje për të hequr një tumor. Duke bërë një rezymë të të gjitha gjërave që kishte bërë në 2018-n, Estela zbuloi për herë të parë se ka hequr një “dreq tumori”, siç e quan ajo. “Hoqa një dreq tumori”, shkruan ajo në ‘Instastory’. Burime për “iconstyle.al” tregojnë se Estela ka bërë një ndërhyrje në gishtin e dorës së djathtë. Pasi bëmë një rishikim të fotove të saj në ‘Instagram’, vumë re se bloggerja kishte fshehur vazhdimisht dorën e djathtë në përpjekje për të mos ta zbuluar ende ndërhyrjen, të paktën deri dje mbrëma. Megjithatë pavarësisht vështirësive, ajo e kujton 2018-n si një vit jo edhe aq të keq pasi u bë nënë për herë të tretë, e një vajze të cilën e lindi në SHBA. “2018-ta ime nuk ishte dhe aq i keq duhet të them”, shkruan Estela në njërin nga fotot ku tregon vogëlushen e saj.

Opinion

i Ditës

# Arsyetim mbi përqasjen tonë

Nga Agred Tafaj

(vijen nga faqja 1)

... zgjedhet e saj si zgjidhje. Në këtë situatë, ne ndiejmë si detyrë që ta kërkojmë vetë rrugëzgjdhjen për përbushjen e 8 kërkesave.

Deri tani kemi rënë dakord se protestat tona nuk janë partiake, dhe se kemi bërë ç'është e mundur të shmangim ndërhyrjet e partive, mashave dhe zgjatimeve të tyre, si dhe të organizatave politike në procesin e orientimit dhe të vendimmarrjes. Deri tani kemi rënë dakord se ne nuk do të negociojmë me qeverinë, por qeveria duhet të marrë përsipër të zgjidhë kërkesat tona, gjë të cilën pretendon se e ka bërë nëpërmjet paktit për universitetin.

Deri tani ne NUK kemi rënë dakord me qeverinë dhe as ekziston një mënyrë që të biem dakord me të, pasi ne nuk kemi kryesi apo përfaqësi të asnjëlloj forme, por thjesht disa prej nesh, për shkak të angazhimit më të madh, janë quajtur koordinatorë të organizimit të protestës.

Në këto rrethana është detyrë e jona që të konsultohemi dhe të biem dakord për rrugën se si do të përbushen 8 kërkesat tona. Prandaj u mbledhëm me date 3 janar ora 18:00 në Fakultetin e Drejtësisë sala 202 koordinatorë, studentë, dhe disa pedagogë nga universiteti të ndryshme. U debatau rreth paktit për universitetin, vazhdimësinë e protestave dhe vendin e zhvillimit të tyre. Në përfundim ramë dakord që pakti për universitetin nuk zgjidh 8 kërkesat, dhe se kërkesat tona zgjidhen me ligj dhe jo me VKM dhe se protesta do vazhdojë para kryeministrit nga data 7, ku të gjithë në të mblidhemi pas bashkimit në 9.30 në fakultetet përkatëse, dhe të vazhdojmë marshimin në 10.00 para sheshit të protestës.

Shfuqizimi i ligjit për arsimin e lartë është kyç ky përplasen interesat tona me interesat dhe pazaret e politikës, si dhe me keqmenaxhimin e sistemit të arsimit për arsye injorance dhe përfitim.

Këmbëngulja jonë në këtë pikë është e vetmja rrugë e mundshme për përbushjen e 8 kërkesave tona. Kushdo që shpreson se kërkesat tona zgjidhen me një VKM, me disa fonde shtesë të hedhura në formë lëmoshe, ose me pazare politike, vetëmashtruhet, ose synon të zhbejë kauzën tonë në shërbim të interesave jashtë nesh.

Strategjia që do të ndjekim mbetet për t'u diskutuar nga masa e studentëve gjatë vazhdimit të protestës. Vetëm në sheshin e protestës mund të merren vendimet e drejta dhe të vërteta. Në dobi të kauzës tonë të përbashkët.

## PSE QEVERIA NUK KA PLOTËSUAR KËRKESAT E STUDENTËVE

Ne studentët kemi paraqitur kërkesa shumë të qarta dhe bazike. Ne fillimisht kemi shkruar para parlamentit dhe kemi kërkuar që plotësimi i kërkesave tona të bëhet nëpërmjet amendimit të ligjit për arsimin e lartë dhe të ligjit të buxhetit, madje që në ditët e para i kemi bërë thirrje Pres-



identit të Republikës për të kthyer ligjin për rishqyrtim në parlament.

Qeveria ka nxjerrë disa vendime dhe urdhra sipas të cilave pretendon se i ka plotësuar të gjitha kërkesat. Kjo nuk është e vërtetë. Qeveria ka premtuar se do të ulë tarifën për disa kategori studentësh dhe ka vënë kriteret. Këto vendime kanë karakter deklarativ, për sa kohë nuk shoqërohen me shifra konkrete se cilat do të jenë kostot që qeveria do të financojë, si dhe ndryshimet e nevojshme në ligjin e buxhetit.

Vendimet deklarative janë thjesht premtime pasi nuk sjellin pasojat financiare konkrete të kërkuara nga ne. Lidhur me përmirësimin e kushteve të jetës në konvikte, qeveria ka folur me shifra konkrete duke vënë në dispozicion 300.000.000 (treqind milion lekë), afro 2.5 milion euro, por i gjithë procesi i rikonstruksionit të konvikteve shtrihet në 3 vjet.

Pra, do të thotë që financimi real është rreth 100.000.000 (njëqind milion lekë) në vit. Nga ana tjetër flitet për tentativa dhe premtime për marrëveshjen me qeverinë gjermane. Edhe këtu financimet e reja janë në kuadër të premtimit dhe vullnetit të mirë. Kërkesat tona themelore ekonomike bazohen në dyfishimin e buxhetit publik për vitin që vjen, dhe në përbushjen e premtimit në vazhdimësi për financimin në arsimin e lartë në masën 5% të GDP. Qeveria ka refuzuar përgjysmimin e tarifave për masterat, gjë të cilën ne e kemi parashtruar qartazi si kërkesë themelore.

2. Për sa i përket grupit të 2-të të kërkesave, qeveria ka nxjerrë disa vendime të sforcuara, me anë të të cilave synon të korrigjojë e të mbushë boshllëqet e krijuara nga ligji në fuqi, dhe të rregullojë e

kërkimit shkencor, sigurisht dhe financimin e jetës së studentit. Edhe ky vendim i qeverisë, plotëson boshllëqet e ligjit të arsimit të lartë, duke mbivendosur kompetencat e qeverisë në ato të parlamentit. Mjaft nga këto koncepte duhet të ishin rregulluar në ligj.

Në këtë situatë, e vetmja rrugë është shfuqizimi i ligjit dhe bërja e tij nga e para.

CITIMI I VKM: Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për Arsimin përgjigjet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrin tri kandidatura. Ministri përgjigjet për arsimin emëron një prej kandidatave të paraqitura nga studentët. Kandidatura e paraqitura nga studentët duhet të plotësojë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

## VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNIES

Është një VKM që nuk garanton kontrollin mbi cilësinë e as qëndrueshmërinë e sistemit. Duke dalë jashtë kuadrit të ligjit, është sjellë koncepti "sondazh kombëtar i studentëve", për të cilin nuk ka përkufizim ligjor sesi do të inkuorohet në këtë proces, çfarë vlerë ka dhe si garantohet objektiviteti i tij.

"Sondazhi i studentëve" ka më shumë karakterin e një premtimi sesa të një zgjidhjeje reale e konkrete që ndikon në kontrollin e performancës së mësimdhënies në IAL. Instrumentet e përcaktuara në dispozicion të agjencisë duhet të kenë karakter ligjor. Thuhet se në grupet e kontrollit marrin pjesë dhe studentët nga universitetet. Kush i përzgjedh, e ç'detyra do të kenë?

I gjithë ky vendim është një arnë e shëmtuar mbi ligjin ekzistues që është në vetvete tejet problematik. E vetmja rrugëzgjidhje mbetet shfuqizimi i ligjit dhe zgjidhja e këtyre problematikave me një ligj të ri.

## PËR GARANTIMIN E TRANSPARANCËS NË IAL

Vendimi i propozuar nga qeveria lidhur me garantimin e transparencës në institucionet e arsimit të lartë është i pabazuar në ligjin në fuqi për arsimin e lartë. Ai i rrefrohet nenit 7/2 pikat B e E të këtij ligji që nuk kanë të bëjnë fare me transparencën.

I gjithë vendimi është një propagandë qeveritare që sido që ta sjellësh nuk prodhon asnjë efekt pozitiv. Së pari, nuk ka asnjë PENALITET për askënd që nuk e kryen transparencën. Së dyti, propozimi i ka rritur fushën e transparencës së veprimtarisë financiare duke përfshirë edhe aktivitetin e ministrisë, ndërkohë që secili prej nesh është i interesuar për transparencën e vetë universiteteve.

Pra, transparenca duke u shtrirë në fushë kaq të gjërë e HUMB QELLIMIN për të cilin e kërkojmë ne. Në këtë VKM "FORMATI I RAPORTIMIT" të transparencës është i posaçëm dhe përcaktohet nga ministri i arsimit dhe financave.

Pra, mbetet në vullnetin politik të qeverisë se cili do të jetë lloji

i transparencës që do të bëhet. Sa të garantuar do jemi në për këtë transparencë të vërtetë?

Sipas kësaj VKM krijohet një strukturë e veçantë pranë ministrisë së Arsimit që garanton transparencën. Pra, në fund të fundit ajo që u ofrohet studentëve është një vendimmarrje e re, por përsëri 100% e bazuar në vullnetin politik po të se njëjtës qeveri, tashmë disi i ndryshuar si refleksim i protestave tona. Por çdo të ndodhë në të ardhmen kur ky vullnet politik të ndodhet në rrethana të tjera? Ku do të bazohet perspektiva për qëndrueshmëri dhe garanci të zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe dijes në universitetet tona?

Ky vendim qeverie është hap-tazi i pabazuar në ligj. Megjithatë me anë të këtij vendimi synohet të plotësohen boshllëqet, të metat dhe gabimet që pikërisht ky ligj përmban në vetvete. Për këtë arsye shfuqizimi i ligjit për arsimin e lartë dhe ribërja e tij nga e para është domosdoshmëri për kontrollin dhe transparencën e financave të IAL-ve.

**PËRVEÇ KËRKESAVE TONA, DISA ÇËSHËTJE TË TJERË QË MËRITOJNË VËMENDJE**

Lëvizja studentore nuk është një përpjekje për të ndryshuar destinacionin e parave publike, mënyrë që ne thjesht të paguajmë më pak dhe të qëndrojmë nëpër universitetet që nuk japin dije të vlefshme për jetën.

Kush e degjeneron lëvizjen tonë thjesht në kërkesa financiare, në ka dyshekë më të mirë konviktësh apo vetëm në ulje tarifash, bën një gabim shumë të rëndë. Ne synojmë para se gjithash të ndryshojmë menyrën sesi planifikohet, programohet dhe realizohet arsimi i lartë në Shqipëri.

Kërkesa për shfuqizimin e ligjit klientelist për arsimin e lartë përmban në vetvete përpjekjen dhe rrugën e vetme për të plotësuar 8 kërkesat e panegociueshme tonat. Asnjë zgjidhje pjesore apo ofertë e pakërkuar nuk do të arrijë të shmangë studentët nga protesta për të drejtat e tyre. Sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri nuk gjendet vetëm në një krizë të thellë financiare si pasojë e dominimit të interesave të ngushta.

Kriza e sistemit universitar, përveçse financiare është thellësisht morale. Ajo është krizë e qeverisjes së universiteteve, dhe vjen si pasojë e keqmenaxhimit dhe sundimit të politikës mbi sistemin arsimor. Kjo krizë nuk zgjidhet thjesht dhe vetëm duke i hedhur para taksapaguesish problemet. Shfuqizimi i ligjit për arsimin e lartë duhet t'i hapë udhën një procesi, rojtare, e nesër të të cilit nuk mund të jenë ata që shkatërruan sistemin universitar dhe.

Protesta jonë në asnjë mënyrë nuk do të lejohet të përdoret nga pushtet mbajtës dhe askush tjetër për të goditur, shantazhuar dhe nënshtruar profesorët. Për ne, profesorët janë njëra nga dy shtyllat e lirisë universitare. Studentët janë shtylla tjetër. Por ama, procesi i vetingut të kërkuar nga ne do të jetë absolutisht objektiv, dhe me 0 ndikim politik.



Opinioni

i Ditës

# Shuplaka brenda vetes

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... opozita për ndërhyrje për përfitim vetjak ose korrupsion, ka ngjallur shpresa tek njerëzit se kapja e qeverisë dhe shtetit nga oligarkët mund të pakësohet në këto dy vite të ardhshme qeverisjeje. Deputeti shtatshkurtër e zëhollë, por i mirinformuar për mbarëvajtjen e tenderave publikë, me dije të sakta për drejtimin e një ekonomie publike, mund të jetë burimi i munguar prej më shumë se 6 vitesh për një informacion të ndershmë e të padevjuar ekonomik ndaj kryeministrit. Në jo pak raste, nëse do ketë këllqe t'u qëndrojnë humoreve gri apo edhe më të errëta të kryeministrit-artist, zv.kryeministri i ri mund të luajë rolin e shpullës së fortë të mikut të vërtetë në ditë të vështirë, që të hap sytë e të largon nga gremina ku je futur. Mungesa e një këshilltari të tillë e ka bërë kryeministrin të përsërisë jo pak herë dy vitet e fundit fabulën aq të bukur (por për fat të keq vetëm trillim, përallë) se kemi ulur borxhin publik, kur po ndodh e kundërta dhe kur informacioni i devjuar po e largon qeverinë nga besimi i njerëzve. Këtë e ka ndjerë kryeministri, që ka lexuar saktë "shuplakën" e protestës studentore, për të provuar të shkëputet nga realiteti aq i bukur, por vetëm virtual (i shtirur) i qeverisjes me njerëzit dhe për njerëzit (pa i mohuar idealin që mund të ketë për këtë të fundit). "Shuplaka" që ka përzgjedhur për ta pasur në ekipin qeveritar duhet t'i japë kryeministrit realitetin mjeran të tenderave qeveritarë me pjesëmarrje të pakët ose asfale të kompanive serioze të huaja (sidomos nga vende aleate strategjike të Shqipërisë, Gjermania, SHBA, Italia, etj.), me justifikimin donkishotesk se gjoja tregjet e kapitalit nuk janë të interesuara për tregun shqiptar dhe ofertat e Buxhetit tonë të Shtetit. Të moskërkimit nga kompanitë vendëse që ndajnë tregun tek ne, të kushtit të pasjes së të paktën 30 për qind të kapitalit për punën e kërkuar (një rregull i pranuar botërisht në investimet në infrastrukturë), duke bërë që kompani me kapital 5 milionë euro të fitojnë dhe nisin një investim (aks rrugor, për shembull) me vlerë 220 milionë euro! Të mungesës së qëllimshme të informacionit për praninë e investuesve strategjikë të huaj të interesuar për shërbime e investime publike, për të futur nga deriçka ofertat e pakërkua të oligarkëve vendës. Dhe pastaj, kur këta oligarkë të paktë janë bërë bozë duke fituar tendera, për t'u thënë: "Shpik-



ni ndonjë kompani të huaj, mundësisht në SHBA (për të gëzuar shefin tonë), që të vijë e ta marrë tenderin në emër tënd". Te afërimit të frikshëm të vitit "zero" kur detyrimet ndaj koncesioneve dhe Partneriteteve Publik-Privat të tejkalojnë rregullin e artë të maksimumit 5 për qind mbi të ardhurat fiskale (për ne tani është 127 milionë euro), duke e bërë Buxhetin e Shtetit pak të aftë ose të paafte të paguajë detyrimet e rritura kapiçë. E vërteta është se borxhi publik po shtohet frikshëm, me detyrimet që nuk paguhen (vetëm për vitin 2017, qeveria qëllimisht nuk shleu 24 mijë fatura në Thesarin e Shtetit, për të mbajtur të ulur artificialisht deficitin buxhetor), me vonesat e qëllimshme me rimbursimet, për të detyruar sipërmarrës të dëshpëruar të paguajnë 10 përqindëshin për të

marrë paratë e veta në kohë, si dhe me detyrimet për shlyerjet vjetore të koncesioneve dhe PPP-ve të reja, që këtë vit do të jenë 25 milionë euro dhe vitin e ardhshëm do të dyfishohen. Realiteti i trishtë është se kemi vërtet një rritje ekonomike prej 4 për qind në vit, por që është anemike dhe nuk prodhon vende të reja pune, në atë numër sa t'u kthejë shpresën njerëzve që të mos kërkojnë në masë t'i largohen vendit, në një kohë kur justifikimi se nga të gjitha vendet ka emigracion ekonomik i ngjan gjethes që përpiqet të mbulojë lakuriqësinë e trupit. Do të jetë në gjendje Zv.kryeministri i ri t'ia bëjë të qarta kryeministrit këto realitete dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjeve të guximshme për t'u shkëputur nga kapja e shtetit dhe zbatuar

politika të mirëfillta zhvillimi? Shumë do të varet nga aftësia e tij për të punuar në një presion të çfarë presin njerëzit nga ai. Do t'i duhet shumë qetësi brenda vetes për të përballuar arradhen administrative, edhe pse nuk ka të drejtë firme. Asnjëherë nuk e ka provuar qeverisjen. Ka bërë gjithnjë tribunin e popullit, duke përqaftuar e mbrojtur kauza të drejta (çlirim të futbollit shqiptar nga oligarkët e vet, e hapësirës publike nga ndërtimet abuzive, etj., etj.). Shpresojmë të arrijë të jetë në lartësinë e detyrës, duke bërë "shuplakën" fshikulluese të shokut të vërtetë dhe të mos katandiset t'i shërbejë "të Gjatit" thjesht për makiazh, me kapitalin që sjell në qeveri të deputetit të pakorrputueshëm, kritikues e kundër rrjedhës.

## HOROSKOPI

### DASHI

Personat e kësaj shenje nuk rekomandohet të mendojnë reth asaj çfarë i pret nesër. Në prag të Vitit të Ri duhet të shmangni dyshimet, frikën apo shqetësimet. Sot do të shpenzoni më shumë se sa ju lejon buxheti. Përbahuni ngado shpenzimi paparshtuar. Ekziston mundësia që zhvillimi i ideve të reja ose lojmi i pozicioneve të fluara më parë të menaohen lehtësisht.

### DEMI

Bëni mirë të mos angazhoheni në punë të lodhshme. Më shumë gjasa do të keni nevojë për pushimin e duhur. Do të ishte mirë të qëndroni në shtëpi, duke pritur vizitat e shokëve të ngushtë, duke biseduar me dikë në telefon, ose duke përgatitur një darkë romantike.

### BINJAKET

Disa Binjakë do ta kalojnë pjesën më të madhe të ditës së sotme të vetmuar. Megjithatë, ka gjasa të takoni një të afërm me të cilin nuk ju pëlqen shumë të bisedoni. Përpuni të mos bëheni pjesë e hashtëmeve, pasi mund të përfshihen në një telash.

### GAFORJA

Ka gjasa që sot të flironi me dikë. Madje, disa persona të kësaj shenje mund të nisin një marrëdhënie të re romantike. Mund të përballeni me dikë me të cilin jeni konfliktuar në të kaluarën. Ata që kanë një llojë të gatë duhet të përmirësojnë disa detaje në marrëdhënien e tyre.

### LUANI

Disa Luanë mund të ndihen të lodhur nga pushimet. Mund të keni disa ide të reja, por ka gjasa të mos mbështeteni nga të afërmit tuaj. Ata që janë kundër udhëtimeve të gjata apo festave të zhurmshme, do ta kalojnë kohën e lirë në shtëpi ose me miqtë e ngushtë.

### VIRGJERESHA

Virgjëreshat nuk do të kalojnë një ditë shumë të këndshme sot. Do të keni telashe në shtëpi për disa çështje të ndryshme. Megjithatë në fund të ditës, atmosfera do të jetë më pozitive.

### PESHORJA

Disa Peshorë do të udhëtojnë gjatë ditës së sotme. Do të ndiheni të relaksuar dhe do të realizoni ato çfarë kishit planifikuar. Nuk rekomandohet që të bëni shopping, pasi mund të shpenzoni më shumë seç kishit menduar.

### AKREPI

Nuk duhet të përfshihen në marrëdhëniet e të tjerëve. Ka gjasa që dikush të veprojë kundër jush. Refuzoni të ndihmoni personat që iu afrohen vetëm për interes. Duhet të keni prioritet familjen.

### SHIGJETARI

Pjesa më e madhe e Shigjetarëve do të jenë të mbushur plot emocione të këndshme. Do të përqendrohen në regullon disa detaje në lidhjen tuaj romantike, të cilat ia keni vënë në dukje edhe partner/partneres suaj. Në punë kërkon ndihmën e dikujt me më shumë eksperiencë se ju.

### BRICJAPI

Mos bëni presion kur të flisni me një person të afërt. Ai/ajo nuk do të jetë dakord me ju nëse vendosni ultimatum. Në mërmje do të jeni dëshmitari i një ngjarjeje shumë emocionuese.

### UJORI

Shumë Ujorë do të kenë dëshirë të ndryshojnë. Është e vështirë të përcaktosh se kur do të ndodhë kjo dhe për çfarë aspekti bëhet fjalë. Bëni kujdes, pasi mund të shkatërroni ato çfarë keni ndërtuar deri tani.

### PESHQIT

Gjatë ditës së sotme, Peshqit nuk kanë gjasa të qëndrojnë të heshtur kur përballen me pa-drejtësi. Kjo situatë do t'ju ndikojë në mënyrë indirekte, por dëshira për të ndihmuar dikë do të jetë e madhe. Megjithatë, gjatë ditës do të përjetoni edhe momente shumë të këndshme.

**BLUE TOOTH**

THASHETHEME

MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta ipave

që të arrijni t'ia

## VENDIMET



## Të kuq të fokusuar te merkatoja e talentëve

## Partizani prezanton Jusufin, bën gati kontratën për Hysenin

Alesio Hyseni, i larguar nga radhët e Flamurtarit, ishte shumë pranë Luftëtarit, ku do të gjente ish-trajnerin e tij, Gentian Mezanin, me të cilin ka punuar edhe në Vlorë. Por gjërat kanë ndryshuar dhe Hyseni do të

luajë për Partizanin në vazhdim. Mesfushori vlonjat ka gjetur akordin me të kuqtë dhe do të vijojë me ta karrierën. Partizani duket se po u beson më shumë lojtarëve me perspektivë. Pasi dhe ka firmosur dhe është prezantuar Fat-

jon Jusufi. Mesfushori ka luajtur për 6 sezone radhazi me ekipin e Renovës në Ligën e Parë të Maqedonisë dhe do të jetë një "armë" shtesë për të ndihmuar ekipin kryeqytetas që të arrijë të fitojë titullin kampion sivjet. Tashmë

vetë klubi i Partizanit e ka bërë zyrtar këtë kalim të tij me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook". "Demat e Kuq" i kanë uruar mirëseardhjen e ngrohtë ku kanë thënë: "Klubi njofton arrijtjen e marrëveshjes me Fatjon Jusufin. Mesfushori me tipare sulmuese, i cili gjatë këtij sezoni ishte pjesë e Renovës në kampionatin maqedonas, ka firmosur një kontratë 2-vjeçare me të drejtë rinovimi edhe për një vit me të kuqtë."

Presidenti Gjici i kënaqur me investimin. Tani pret të korë frytet dhe të fitojë titullin

# Rroca e Shkurtaj! Kukësi nis presionin ndaj Partizanit

Verilindorët kanë kompletuar dy repartet e brishta

Dy lëvizje të rëndësishme pa nisur ende zyrtarisht merkato. Kukësi përveçse zyrtarizoi Eduart Rrocën për të cilin kish kohë që ish konfirmuar kalimi tek blutë, rrëmbëu edhe një tjetër element të shumëllojshëm në merkato Vasil Shkurtajn. Dy futbollistë që i kanë shtuar tej mase potencialin nënkampionëve të Shqipërisë jo vetëm në garën për titull, por edhe për një rrugëtim të gjatë në kompeticionet europiane ku pjesëmarrja në grupet e Europa Leagues mbetet ëndrra e presidentit Gjici. Pikërisht ky i fundit në prezantimin e dy lojtarëve në fjalë dha një sinjal të qartë për trajnerin Armando Cungu. Tekniku shkodran në vështirësi e sipër gjeti formulën 3-4-3, e cila deri më tani ka funksionuar në mënyrë të përkryer aq sa blutë në 5 javë i rikuperuan 12 pikë Skënderbeut dhe 6 pikë Partizanit, atëherë si do të gjendet një rrugë për t'i aktivizuar afrimet e fundit pa prekur modulën, në fakt, duket e vështirë. Rroca mund të pozicionohet në mesfushë duke mbuluar rolin që mbahej nga Donjet Shkodra, çështja është a mund



të bashkëjetojnë Shkurtaj dhe Reginaldo, nëse nuk ndryshon skema atëherë ndoshta mozambikasi do të spostohej në të djathtë të sulmit me Shkurtajn në qendër, në të kundërt nën skemën 3-5-2 të dy futbollistët do të qëndronin më pranë njëri-tjetrit duke formuar një repart sulmues të paktën në letër ndër më të mirët në Superiore. Ndoshta një problem që i kushtoi shumë pikë

Kukësit në startin e sezonit mund të rishfaqet sërish fiala është për përshtatjen e lojtarëve të rinj, gjithsesi është e qartë që ky Kukës i për momentin i ka të gjitha letrat në rregull për t'u shpallur kampion. Ndërkohë verilindorët kanë mbërritur në Antalia ditën e djeshme, ku do të kryejnë fazën përgatitore për të qenë gati më 20 janar, ditë kur do të nisë edhe pjesa e dytë e sezonit. Kukësi

e rifillon kampionatin me 3 pikë më pak sesa Partizani kryesues, por me ardhjen e Rrocës dhe Shkurtajt, pozitën e nënkampionëve janë fuqizuar shumë. Gjatë qëndrimit 12 ditor në Antalia, drejtuesit verilindorë kanë mundur të organizojnë edhe dy takime miqësore, të parën më datë 9 janar kundër turqve të Istanbul Bashaksehirit dhe të dytën më 11 janar kundër rusëve të Rostovit.

## FLET MESFUSHORI

## Rroca: Me Shkurtajn do të fitojmë shumë

Mesfushori i ri i Kukësit, Eduart Rroca ka folur pas prezantimit të tij zyrtar të ekipi verilindor, ku tregoi objektivat, marrëdhëniet me Shkurtajn dhe ambientimin të skuadra e re. 25-vjeçari u shpreh: "Është e vërtetë që kemi pasur kërkesa dhe një nga skuadra e interesuara ka qenë dhe Shkëndija. Por nuk erdhi asnjëherë një ofertë konkrete dhe unë e kam thënë edhe më përpara që do të shkoj te skuadra që më do më shumë. Kukësi më kërkoi me ngulm dhe zgjedhja ime ishte e qartë. Ardhja të Kukësi është një hap i mirë për mua. Ky klub ka një projekt ambicioz dhe kjo është diçka shumë e rëndësishme për mua. Jam në një moshë të pjekur tashmë dhe dua të jap maksimumin këtu. Gjatë vitit të kaluar, nuk kam qenë në 100% tim për shkak dëmtimi. Tani do të punoj shumë në fazën përgatitore dhe shpresoj ta nis vitin në formën e duhur fizike. Shkurtajn e njoh mirë, pasi kemi luajtur prej vitesh së bashku dhe kjo gjë do të na ndihmojë të ambientohemi sa më shpejt te skuadra e re", u shpreh Rroca.

## SULMUESI FIERAK

## Fili divorcohet me Skënderbeun, mund të firmosë në Maqedoni

Realdo Fili e ka mbyllur me Skënderbeun. Sulmuesi Ranësor në verë shkoi në Korçë në pretendime të mëdha, por në asnjë moment nuk e pa veten në qendër të vëmendjes. Fieraku në ndeshjen e fundit u preferua si titullar nga trajneri Orges Shehi, por më e mira e menduar nga ai ka qenë që ta mbyllte aventurën e tij me Skënderbeun tani. Kështu ka ndodhur dhe Fili ka deklaruar se arsyet e divorcit ka lidhje me aktivizimin e pakët. Gjithsesi, pas aventurës me fanellën bardhëkuqe dhe tanimë pret të nisë një eksperiencë të re. Ofertat nuk i mungojnë dhe shumë shpejt do të zgjedhë edhe skuadrën e tij të re.

## MEDIAT SPANJOLLE E BËJNË FAKT

## Alegri ikën nga Juvja, e zëvendëson Zidan

Maksimiliano Alegri do të largohet nga ekipi i Juventusit në fund të sezonit. Kjo sipas të përditshmes "Mundo Deportivo", e cila ka thënë se sido që të shkojë këtë sezon, fiton apo jo, trajneri italian ka vendosur të largohet nga "Allianz Stadium". Alegri ka kaluar një kohë mjaft të mirë me klubin bardhezi, ku ka pasur katër vite të suksesshme duke prekur finalët e Ligës së Kampionëve dhe duke fituar kampionatin. Sipas medieve spanjolle teknikun do të marrë drejtimin e Ligës së Kampionëve do të jetë i gatshëm për një aventurë në Premierligë. Juventus ka një ëndërr, Zinedine Zidane. Është ai lojtari që drejtuesit e klubit torinez po ngulmojnë të sjellin në Itali. Ish-futbollisti francez ka qenë më parë pjesë e Juventusit dhe si trajner ka bërë mjaft mirë duke arritur me Realin e Madridit atë që askush nuk e kishte arritur më parë, fitimin e 3 Ligave të Kampionëve radhazi.

## DURRSAKËT FIRMOSIN ME 30-VJEÇARIN




## Zyrtare, Teuta prezanton Erlis Frashërin

Lajmi ishte bërë i ditur ditë më parë, por tani është bërë zyrtar nga klubi durrsak, që me një postim në faqen e vet në "Facebook", ka njoftuar marrëveshjen me Erlis Frashërin. Mbrojtësi i krahut të djathtë, i cili në pjesën e parë të sezonit luajti me Kamzën, kthehet te Teuta, ku është aktivizuar më parë për dy sezone. Trajneri Shkëmbi sistemon kështu krahun e djathtë, pas largimit të maqedonasi Gjeorgjevski. Korçari është bashkuar me ekipin e ri në stërvitje. "Teuta ka zyrtarizuar afrimin e parë për këtë merkato. Klubi durrsak ka firmosur me Erlis Frashërin, mbrojtësin 30-vjeçar. Më parë, Frashëri ka luajtur me ekipin e Kamzës, ndërsa tek Teuta vjen për herë të dytë pasi ka qenë pjesë e kësaj skuadre për dy sezone 2010-2012", lexohet në njoftimin e klubit durrsak.

donasi Gjeorgjevski. Korçari është bashkuar me ekipin e ri në stërvitje. "Teuta ka zyrtarizuar afrimin e parë për këtë merkato. Klubi durrsak ka firmosur me Erlis Frashërin, mbrojtësin 30-vjeçar. Më parë, Frashëri ka luajtur me ekipin e Kamzës, ndërsa tek Teuta vjen për herë të dytë pasi ka qenë pjesë e kësaj skuadre për dy sezone 2010-2012", lexohet në njoftimin e klubit durrsak.



## Fjalëkryqi (1)



## HORIZONTAL

1. Me të nxjerrin një tapë.
4. Inicialet e Klee piktor.
6. Qiriaçi aktor.
9. Etikë pa kufij.
11. Merren për shembull.
14. Fund janari.
15. Janë edhe ata të skuadrës.
17. Ortolani kompozitor.
18. Ushtrohej edhe nga bukanierët.
20. Në krye të sondazheve.
21. Janë të ndaluar në kthesë.
23. Ente Rajonale Civile.
24. Gjermania në tabela.
25. Mund të jetë unik.
27. Philippe që qe aktor.
29. Një pjesë e pelegrinazhit.
31. Gjysmë leader.
32. Maten pa zë.
33. Janë të përpjeta.
35. Qytet anglez.

36. Louis, poet surrealist.
38. Artet pa re.
39. Matet pa kufij.
40. Gruaja e Ben Hur.
42. Liam i Schindler's list.
45. Të parat në orkestër.
47. Makina Ibiza.
48. Renato, piktor i famshëm italian.
49. Mihali këngëtare lirike.

## VERTIKAL

1. Mbyllin fushata.
2. Një pjesë e pikturave.
3. Janë njëvjeçarë.
4. Një ngjyhet në tavolocë.
5. Eshhtë katolik ai i papës.
6. Mbyllin portat.
7. Opera e Mascagni-t.
8. Tregohet duke bërë masakra.
10. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
11. Një gjuajtës francez.
12. Eshhtë porti i Durrësit.
13. Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
16. Pak pirografi.
19. Një pjesë e aerobisë.
21. U vodni zjarrin perëndive.
22. Premtojnë të bëhen asa.
23. Mbeten në fund.
26. Rreth pa ekstreme.
28. Rendi pa zë.
29. Eshhtë veshje tahitianësh.
30. Tase e voleybollit.
33. Eshhtë shahu i fundit.
34. Kim... Stuart aktor.
35. Fritz regjisor.
37. Ai i shtatë është kinemaja.
39. Një pjesë e ansambilit.
41. Diftong teatral.
43. Të parat në stacion.
44. Qendër në tour.
46. Mbarojnë fare.


## Fjalëkryqi (2)

## HORIZONTAL


1. Harris aktor.
3. Termocentrali i shkurtër.
5. Organizata me koska.
10. Një tufë bagëti.
12. Inicialet e Redford.
14. Kështu thonë se bëhet ai që mërzhitet.
15. Scarlet e Bashkë e erën.
17. Elvira aktore.
19. Eshhtë Panorama që ke në dorë.
21. Ushtojnë nga "ola".
22. Shtet aziatik.
24. Eshhtë ministri.
25. Në radhtë të parë.
26. G... për njerëzit e FBI.
27. Makina Micra.
31. Mund të jetë proteste.
32. Pasur pa kufij.
33. Gjika e Dora d'Istria.
36. Të fundit në dhjetor.

## VERTIKAL


1. Umberto që shkroi Baudolino.
2. Bertë këngëtare italiane.
3. Fillojnë një temë.
4. Një garë në hipodrom.
6. Qe burri i parë.
7. Një ndriçues.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. I dha fillin Tezetur.
10. Vihen për të mbyllur.
11. Para Saint-Germain në futboll.
13. Qëllon në një vend.
16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
17. Janë përmasat.
18. Mbush në kufij.
20. I bëjnë duart me ar.
21. Inicialet e dali piktor.
23. Fillojnë argumentin.
28. Makina Ibiza.
29. Emri i Einstein.
30. Ndrriçojnë rrugët.
31. Kim që qe aktore.
32. I hedh i dorzuar.
34. Inicialet e Nolte aktor.
35. Ishin rapsodët e akejeve.
37. Fund shkurti.
40. Van der portier holandez.
44. Fillojnë masat.
46. Inicialet e Rohmer.
47. Fillojnë teorikisht.
49. Numër i shkurtër.




## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

## SUDOKU

1			2			3		6
9					7	4	2	
	7							1
				4	5			7
	1			9	6			
2	4	5			8			
	5	8	7	3	2			
	6						3	
			9					4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	2	9	3	5	1	8	6	7
3	1	6	9	8	7	2	5	4
7	5	8	2	4	6	3	9	1
5	4	1	6	7	2	9	8	3
9	3	2	4	1	8	5	7	6
8	6	7	5	3	9	1	4	2
2	7	5	8	6	3	4	1	9
6	8	3	1	9	4	7	2	5
1	9	4	7	2	5	6	3	8

Argëtim  
filozofik

- Kurrë mos ndalo të buzëqeshësh, edhe kur nuk jeni të lumtur. Dikush mund të biejë në dashuri me buzëqeshjen tuaj.

- Të drejtat e grave janë detyrime të burrave...

- Trishtimi i tepërt qesh. Gëzimi i tepruar qan.

- Të gjithë jetojnë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.

Thënie  
të mençura

- Mos zgjidhni një rrugë pa pengesa, me siguri nuk do të të çojë askund.
- Një mashkull i mençur duhet të puthë pa dashuri të ndahet para se ta ndajnë dhe të harrojnë pa u harruar.

## KRIPTOSKEME

## KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	P	1	U	6	S	I	15	2	3	5	7	3	S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T			
2	4	8					4	7		8	6		9	1	A	R	M	I	K		S	T	O	L	I	T	E
6	1		3	10	9	10	4	1	11	8	5				L	I	O		R	O		M	I	N	A	T	
12		3	8	11	7	4	8	13	8		5				L	O		C	A	B	A	R	E	T		L	A
5	4	1	3	8	11	7	16	7	13	8					A		B	A	T	E	R	I	T	E		A	R
10		3	8	5	8	5	1	11	8	5					T	R	I	M	E	R	I	T	E		A	N	E
5		10	6	8		1	5		5	7	18				A	R	T	U	R	O	U	I		M	A	T	T
1	8	4				3	4	8	11	1	13	10			A	R	S	E	N		E	A		A			
4	1	17	12	8	10	4			6	1	9				A	A	D	A		T		M	E	T	R	I	C
6	5	1	9	10	5		10		2	15	10				P	A	K	T		P	I	R	A	T	E	R	I
4	2	16				8		2	15	10					K	U	A	L	I	T	E	T	I		E	P	
4	1	17	12	8	4	18			5	8					L	E	C	E	P	I		N	A	T	A		

- "Forma më e lartë e inteligjencës njerëzore, është aftësia për të vëzhguar pa gjykuar."
- Kur një njeri të shkakton zemërim, do të thotë se ai është më i fortë se ti.



[www.gsh.al](http://www.gsh.al)  
**GAZETA SHQIPTARE**

# Gazeta e gjithë shqiptarëve!



**Kontakt: +355 68 40 63 842**

Facebook: **Gazeta Shqiptare**  
 Instagram: **gazetashqiptare.al**  
 Twitter: **Gazeta Shqiptare**  
 E-mail: **gazetashqiptare.al@gmail.com**  
 YouTube: **Youtube: Gazeta Shqiptare**

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!



[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)